



GAZETA ZYRTARE

E KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS

Nr. 5

Prishtinë, 21 shkurt 1986

VITI XLI

Në bazë të nenit 335 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, jap

DEKRET

PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI NDËRTIMIN E OBJEKTEVE INVESTIVE

Shpallet Ligji mbi ndërtimin e objekteve investive, që e aprovoi Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e Dhomës së Punës së Bashkuar, më 28 janar 1986, në mbledhjen e Dhomës së Komunave, më 28 janar 1986 dhe në mbledhjen e Dhomës Shoqërore-Politike, më 28 janar 1986.

KK Numër 011-48/85
Prishtinë, 28 janar 1986

Kryetari i Kuvendit
Abaz Kazazi, d.v.

LIGJI

MBI NDËRTIMIN E OBJEKTEVE INVESTIVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet ndërtimi dhe rikonstruktimi i objekteve investive.

Dispozitat e këtij ligji aplikohen në ndërtimin e objekteve investive, po që se me këtë ligj ose me ligj të veçantë nuk është caktuar ndryshe.

Neni 2

Ndërtim i objektit investiv, në vështrim të këtij ligji, konsiderohet zhvillimi i punimeve paraprake e përgatitore, projektimi dhe ndërtimi i objektit investiv.

Neni 3

Objekte investive në vështrim të këtij ligji konsiderohen objektet e ndërtimit, objektet e ndërtimit me instalime, impiante e pajisje të montuara që i shërbejnë destinimit të objektit investiv dhe instalimet, impiantet e pajisjet që montohen në objektin e ndërtimit.

Neni 4

Punime paraprake në vështrim të këtij ligji konsiderohen kërkimet, përveç kërkimeve në xehetari,

hartimi i studimeve dhe i zgjidhjeve ideore, mbledhja e të dhënave dhe sigurimi i kushteve të projektit, si dhe punimet e tjera që shërbejnë për hartimin e programit investiv.

Punime përgatitore në vështrim të këtij ligji konsiderohen punimet rreth përgatitjes dhe rregullimit të tokës për ndërtimin e objektit, ndërtimi ose vendosja e objekteve me karakter të përkohshëm që duhet të ndërtohen ose të vendosen në kantierin e ndërtimit para ose gjatë ndërtimit (rrugët, largpërcuesit, objektet për vendosjen e punëtorëve etj.), rrethimi i kantierit të ndërtimit dhe kryerja e punimeve të tjera me të cilat sigurohen objektet fqinje, komunikacioni dhe jeta e shëndeti i njerëzve.

Hartim i programit investiv në vështrim të këtij ligji konsiderohet hartimi i analizës së kushteve të ndërtimit dhe hartimi i elaboratit për ndërtimin e objektit investiv dhe arsyeshmërinë e ndërtimit të objektit investiv.

Projektim në vështrim të këtij ligji konsiderohet hartimi i dokumentacionit tekniko-projektues.

Neni 5

Ndërtim përkatësisht rikonstruktim i objektit në vështrim të këtij ligji konsiderohet zhvillimi i punimeve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare, montimi i instalimeve dhe instalimi përkatësisht montimi i aparateve, i impianteve dhe i pajisjeve.

Ndërtim i objektit në vështrim të këtij ligji konsiderohet edhe zgjerimi i objektit ekzistues.

Rikonstruktim i objektit në vështrim të këtij ligji konsiderohet zhvillimi i punimeve në objektin ekzistues me të cilat bëhet sahim, adaptimi, ndërrimi i instalimeve, i aparateve, i impianteve dhe i pajisjeve, ndryshimi i procesit teknologjik të prodhimit ose zhvillimi i punimeve të tjera në objekt, po që se me këto punime: ndryshohen disa elemente të konstruksionit, pamja e jashtme e objektit, destinimi i objektit ose kushtet sipas të cilave është lejuar ndërtimi i objektit, ndikohet në stabilitetin e objektit, sigurinë e objekteve fqinje, të komunikacionit e të rrethinës, në sigurinë nga zjarri, nuk ndikohet në mënyrë të dëmshme në ambientin e jetës e të punës, në shëndetin dhe jetën e njerëzve, ndryshohet regjimi i ujërave apo nëse ndryshohen kushtet sipas të cilave është lejuar ndërtimi i objektit që gjendet në rrethinën e të mirave të paluajtshme kulturore.

Nuk konsiderohet rikonstruktim zhvillimi i punimeve rreth mirëmbajtjes së objektit ekzistues me qëllim të përdorimit normal të tij, siç janë: ndërrimi i instalimeve dhe i disa aparateve në objekt, po që se me këto punime nuk ndryshohen kushtet sipas të cilave është lejuar ndërtimi i objektit, as punimet në objektet e banimit dhe në banesa me të cilat përmirësohen kushtet e banimit (ndërrimi i dyshemeve, i

mbulesave të mureve, i pllakave, i lamperisë, i elementeve sanitare, meremetimi i fasadës). Nuk konsiderohet rikonstruktimi as zhvillimi i punimeve në pastrimin dhe konservimin e freskave.

Neni 6

Mbi ndërtimin e objektit investiv vendos investuesi.

Investues në vështrim të këtij ligji është çdo person juridik-shoqëror, i cili merr vendimin për investime dhe financim ndërtimin, përkatësisht rikonstruktimin e objektit.

Kur në ndërtimin dhe financimin e objektit marrin pjesë disa subjekte, secili prej tyre ka statusin e investuesit. Kryerja e punëve të investuesit mund t'i besohet njërit nga pjesëmarrësit në financimin e objektit.

Bashkinvestuesit kanë për detyrë që në rastin nga paragrafi 2 i këtij neni të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë reciproke t'i rregullojnë me marrëveshjen vetëqeverisëse ose me kontratën me shkrim, e sidomos këto çështje: mënyrën dhe kushtet e sigurimit e të shfrytëzimit të mjeteve; sigurimin e mbikëqyrjes së vazhdueshme të realizimit të programit investiv; mënyrën e zgjedhjes së teknologjisë; autorizimet dhe kufijtë e autorizimeve lidhur me marrjen përsipër të obligimeve; përgjegjësinë për kryerjen me kohë të të gjitha punëve të investuesit dhe për marrëdhëniet financiare reciproke; marrëdhëniet juridike-pasurore dhe çështjet e eksploatimit të objekteve.

Kur objekti financohet nga mjetet e bashkuara në bashkësinë vetëqeverisëse të interesit, statusin e investuesit e ka secili nga bashkuesit e këtyre mjeteve. Kryerja e punëve të investuesit mund t'i besohet bashkësisë vetëqeverisëse të interesit, njërit nga bashkuesit e mjeteve ose personit tjetër juridik-shoqëror që i plotëson kushtet për kryerjen e punëve të investuesit të përcaktuara me këtë ligj, e në pajtim me marrëveshjen vetëqeverisëse mbi bashkimin në bashkësinë vetëqeverisëse të interesit.

Neni 7

Ndërtimi i objektit investiv mund të fillojë pasi të jenë plotësuar kushtet e përcaktuara me ligj.

Ndërtimin e objekteve investive e bëjnë organizatat e punës së bashkuar të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së këtyre, po qe se me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

Neni 8

Objekti i ndërtuar investiv mund të shfrytëzohet pasi të merret leja për përdorim.

Neni 9

Ndërtimin dhe rikonstruktimin e objekteve të qytetarëve dhe të personave juridikë-civilë e rregullon kuvendi i komunës.

Me rastin e ndërtimit dhe të rikonstruktimit të objekteve të qytetarëve e të personave juridikë-civilë, aplikohen dispozitat dhe standardet teknike që kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve investive.

Neni 10

Dispozitat e këtij ligji nuk aplikohen në ndërtimin e objekteve investive ose në zhvillimin e disa punimeve që bëhen, përkatësisht zhvillohen mu para se të ndodhin ose gjatë kohës që ndodhin fatkeqësi

të natyrës ose ngjarje të tjera të paparashikuara dhe për mënjanimin e drejtpërdrejtë të pasojave të dëmshme të këtyre fatkeqësive ose ngjarjeve.

Objektet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të mbesin si objekte të përhershme edhe pasi të pushojnë së ekzistuari rrethanat që kanë shkaktuar ndërtimin e tyre, po qe se i plotësojnë kushtet e caktuara urbanistike, teknike dhe kushtet e tjera të përcaktuara për ndërtimin e objekteve investive dhe në qoftë se investuesi merr lejen për përdorimin e këtyre objekteve brenda afatit prej gjashtë muajsh pasi të kenë pushuar së ekzistuari rrethanat që kanë shkaktuar ndërtimin e tyre ose brenda afatit më të gjatë, të cilin e cakton organi komunal i administratës kompetent për punët e inspeksionit të ndërtimeve.

Në qoftë se investuesi nuk e merr lejen për përdorimin e objektit të përkohshëm brenda afatit nga paragrafi 2 i këtij neni, ka për detyrë që objektin ta rrëzojë, përkatësisht ta heqë brenda afatit të cilin e cakton organi komunal i administratës kompetent për punët e inspeksionit të ndërtimeve dhe i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

Neni 11

Dispozitat e këtij ligji nuk kanë të bëjnë me objektet e vogla të montazhit që vendosen përkohësisht në tokën për ndërtime ose në sipërfaqet publike (barakat e montazhit për shitjen e produkteve ushqimore, qoshqet për shitjen e duhanit, të gazetave, të suvenirëve, të biletave të lotarisë, të bizhuterisë, të luleve dhe të mallrave të ngjashme, barakat e montazhit për kryerjen e shërbimeve zjettare dhe të shërbimeve të tjera, garazhet e montazhit, kampshhtëpizat dhe objektet e tjera të ngjashme).

Kuvendi i komunës përcakton se cilat objekte të vogla montazhi dhe në çfarë kushtesh mund të vendosen në tokën për ndërtime ose në sipërfaqet publike brenda kohës për të cilën mund të mbeten përkohësisht në këtë tokë, përkatësisht në këtë sipërfaqe.

Neni 12

Dispozitat e këtij ligji nuk kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve ushtarake dhe të objekteve të tjera në rrethinën ushtarake.

Neni 13

Përgatitjet për ndërtim dhe ndërtimi i objektit investiv mund të fillojë po qe se ndërtimi i objektit investiv është parashikuar me planin afatmesëm të zhvillimit të investuesit.

Përgjatimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, përgatitjet për ndërtim dhe ndërtimi i objektit investiv mund të fillojë edhe kur ndërtimi nuk është parashikuar me planin e zhvillimit të investuesit, po qe se nevoja e ndërtimit të objektit investiv është shfaqur si pasojë e prishjes ose e asgjësimit të objektit investiv ekzistues.

II. VENDIMI MBI NDËRTIMIN E OBJEKTIT INVESTIV

1. Mënyra e marrjes së vendimit

Neni 14

Vendimin mbi ndërtimin e një objekti, investuese e të cilit është organizata themelore e punës së bashkuar, e marrin punëtorët e kësaj organizate në pajtim me Ligjin mbi riprodhimin e zgjeruar dhe punën e kaluar („Gazeta Zyrtare e RSFJ”, nr. 21/82).

Vendimi mbi ndërtimin e objektit investiv merret në bazë të programit të investimit, ndërsa për objektet për të cilat organi kompetent i investuesit me rastin e miratimit të programit të investimit ka

vlerësuar se është më racionale dhe më e arsyeshme në pikëpamje shoqërore-ekonomike dhe se kushtet objektive të ndërtimit kërkojnë që para se të cedohet ndërtimi i një objekti të hartohet dokumentacioni tekniko-projektues, vendimi mbi ndërtimin e objektit investiv merret në bazë të programit të investimit dhe të dokumentacionit tekniko-projektues.

Me vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni caktohen:

1. objekti investiv që është objekt ndërtimi investiv;
2. burimet dhe shuma e mjeteve financiare të nevojshme për ndërtimin e tërë objektit investiv ose për ndërtimin e disa pjesëve të tij, të cilat përbëjnë një tërësi ekonomiko-teknike dhe si të tilla mund të shfrytëzohen në mënyrë të pavarur, po qe se parashikohet ndërtimi i objektit investiv sipas pjesëve dhe mjetet qarkulluese të përcaktuara sipas programit të investimit;
3. mënyra e sigurimit të mjeteve dhe
4. afatet brenda të cilave do të ndërtohet objekti.

Neni 15

Investuesi ka për detyrë që me rastin e vendosjes mbi ndërtimin e objektit investiv dhe gjatë ndërtimit të objektit investiv, si dhe gjatë kryerjes së punimeve të tjera lidhur me këtë ndërtim të kujdeset për arsyeshmërinë dhe oportunitetin ekonomik e shoqëror të objektit investiv dhe të ndërtimit të tij.

Neni 16

Para se të merret vendimi mbi ndërtimin e objektit, të cilin e marrin punëtorët me anë të deklaratimit personal, investuesi ka për detyrë të marrë mendimin mbi arsyeshmërinë shoqërore dhe ekonomike të investimeve në ndërtimin e këtij objekti nga organet dhe organizatat, të cilat janë caktuar me ligj që të japin mendime lidhur me arsyeshmërinë shoqërore dhe ekonomike të formimit të organizatave punuese.

Kur vendimin mbi ndërtimin e objektit e merr organi i qeverisjes i investuesit, në pajtim me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës të miratuar me anë të deklaratimit personal të punëtorëve, mendimi mbi arsyeshmërinë shoqërore dhe ekonomike të investimeve në ndërtimin e këtij objekti merret nga subjektet juridike-shoqërore që janë caktuar me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës të investuesit.

Në qoftë se me programin e investimit është parashikuar importimi i pajisjeve dhe i materialit, investuesi ka për detyrë të marrë mendimin mbi arsyeshmërinë shoqërore dhe ekonomike.

Për mendimin që e ka marrë investuesi ka për detyrë t'i njoftojë punëtorët. Mendimi i bashkangjitet dokumentacionit në bazë të të cilit merret vendimi mbi ndërtimin e objektit.

Neni 17

Për ndërtimin e objektit investiv, si rregull, hartohet një program i investimit, e mund të hartohen programe për pjesët e objektit investiv që përbëjnë një tërësi ekonomiko-teknike dhe që si të tillë mund të shfrytëzohen në mënyrë të pavarur, po qe se ndërtimi i objektit investiv parashikohet sipas pjesëve.

Për ndërtimin e disa objekteve investive të ndërlydhura në mënyrë funksionale investuesi mund të hartojë një program të investimit.

Neni 18

Programi i investimit, varësisht nga lloji dhe natyra e objektit investiv, përmban sidomos:

1. përshkrimin e objektit investiv me të dhënat për destinimin, kapacitetin dhe programin e prodhimit, përkatësisht të eksploatimit të tij;

2. arsyet dhe provat për arsyeshmërinë ekonomike, teknike, teknologjike dhe shoqërore të ndërtimit të objektit investiv;

3. vlerën parallogaritare të investimeve të gjithmbarshme, me të dhënat për shumën e mjeteve të nevojshme për ndërtimin dhe fillimin e punës së objektit bashkë me propozimin sipas llojeve të punimeve lidhur me kushtet e ndërtimit, si dhe burimet dhe mënyrën e sigurimit të mjeteve;

4. provat se ndërtimi i objektit investiv është parashikuar me planin afatmesëm të zhvillimit të investuesit;

5. të dhënat dhe provat se ndërtimi i objektit investiv është në pajtim me planin hapësinor, përkatësisht me planin urbanistik ose me planin e hollësishtëm urbanistik, me projektin urbanistik ose me projektin e veçantë urbanistik;

6. të dhënat dhe provat se ndërtimi i objektit investiv është në pajtim me kushtet e ekonomisë ujore, të energjetikës, të komunikacionit dhe me kushtet e tjera për rajonin në të cilin ndërtohet objekti investiv;

7. zgjidhjen e projektidesë së objektit investiv;

8. analizën e kushteve të ndërtimit të objektit investiv me afatin e kohëzgjatjes së ndërtimit;

9. kushtet sipas të cilave investuesi do të cedojë ndërtimin e objektit investiv;

10. mënyrën në të cilën investuesi do të bëjë kontrollin e dokumentacionit tekniko-projektues;

11. pasqyrën e pajisjeve e të teknologjisë themelore dhe të konceptit teknologjik-prodhues, përkatësisht të eksploatimit të objektit investiv, e veçanërisht pasqyrën e burimeve të sigurimit të lëndëve të para e të materialit riprodhues të nevojshëm dhe të burimeve të energjisë sipas llojeve e vëllimit dhe sigurimit e numrit të nevojshëm të punëtorëve;

12. analizën e kushteve të eksplotimit të objektit investiv, duke vënë në dukje fillimin e eksplotimit, analizën e treguesve — efekteve themelore ekonomike, kurse për objektet ekonomike edhe analizën e kushteve dhe të mundësive të shitjes së mallrave, përkatësisht të shërbimeve në tregun e vendit dhe në atë të jashtëm;

13. të dhënat për ekzaminimet gjeomekanike dhe ekzaminimet e tjera të nevojshme të tokës në të cilën do të ndërtohet objekti investiv;

14. analizën e ndikimeve të mundshme të objektit mbi ambientin e jetës e të punës së njeriut dhe masat për mbrojtjen dhe përparimin e tij, si dhe për shfrytëzimin e kapacitetit të lejuar të rrethinës dhe

15. masat me interes për mbrojtjen popullore, të caktuara me planin e mbrojtjes popullore për rajonin në të cilin ndërtohet objekti, masat e mbrojtjes nga veprimet e luftës dhe masat e tjera të caktuara me plan ose me dispozita të veçanta.

Dispozitat e paragrafit 1 pika 4 të këtij neni nuk aplikohen në rast se nevoja për ndërtimin e objektit investiv është shfaqur sipasojë e prishjes ose e asgjësimit të objektit investiv ekzistues.

Neni 19

Në qoftë se objekti investiv për nga natyra e vet është i lillë që me ekzistimin, përdorimin ose me veprimtarinë e vet që do të ushtrohet në të do të mund t'i shkaktonte dëm ambientit, me programin e investimit duhet të parashikohen instalime dhe masa me të cilat ky dëm do të pengohet, përkatësisht do të reduktohet në masën e lejuar me ligj ose me dispozitën e nxjerrë në bazë të ligjit.

Neni 20

Punimet paraprake në bazë të të cilave hartohet programi i investimit, e të cilat shërbejnë si bazë profesionale që të merret vendimi mbi ndërtimin e objektit, investuesi mund t'i zhvillojë vetëm në qoftë se ka në dispozicion pajisje të nevojshme teknike e teknologjike dhe kuadro ose nëpërmjet bashkësisë punuese të organizatës punuese në kuadër të së ci-

lës është, përkatësisht nëpërmjet organizatës së punës së bashkuar ose organizatës dhe bashkësisë tjetër vetëqeverisëse të specializuar për llojin e caktuar të punimeve shkencore ose kërkimore.

Zhvillimin e punimeve paraprake mund ta organizojnë e ta financojnë bashkërisht disa investues, në qoftë se ndërtimi i objektit të llojit dhe të destinimit të njëjtë ose të ngjashëm parashikohet me planin e këtyre organizatave brenda periudhës së njëjte.

Investuesi ka për detyrë që gjatë zhvillimit të punimeve paraprake dhe hartimit të programit të investimit, si dhe gjatë ndërtimit të objektit t'i shfrytëzojë njohuritë e arritura shkencore e teknike, të dhënat për teknologjinë bashkëkohore të prodhimit në kuadër të veprimtarisë që do ta ushtrojë, si dhe të dhënat për teknologjinë dhe materialet e vendit.

Neni 21

Organi i qeverisjes i investuesit dhe organi punëdrejtues kanë për detyrë që gjatë zhvillimit të punimeve paraprake t'i ndjekin rezultatet e kërkimeve dhe të punimeve të tjera profesionale në mbledhjen dhe analizën e të dhënave dhe kushteve të ndërtimit të objektit dhe që për këto rezultate t'i njoftojnë punëtorët, përkatësisht subjektet që marrin vendimin mbi ndërtimin e objektit dhe subjektet që kanë marrë iniciativën për investimin e mjeteve në ndërtimin e objektit.

Neni 22

Hartimin e programit të investimit investuesi mund t'ia besojë organizatës së punës së bashkuar, e cila është e regjistruar në regjistrin gjyqësor për kryerjen e punëve të hartimit të dokumentacionit teknik ose organizatës, e cila është e regjistruar në regjistrin gjyqësor për kryerjen e shërbimeve teknike, ekonomike dhe organizative (në tekstin e mëtejshëm: shërbimet konsalting).

Programin e investimit, pa u regjistruar në regjistrin, mund ta hartojë edhe investuesi për nevojat e veta ose bashkësisë punuese e organizatës punuese në kuadër të së cilës është, po qe se i plotëson kushtet sa i përket kuadrit profesional të përcaktuar për organizatat e punës së bashkuar që kryejnë punët e hartimit të dokumentacionit teknik.

Organizata e punës së bashkuar, e cila kryen punët e hartimit të dokumentacionit teknik, mund të hartojë programin e investimit për ato lloje të objekteve, për të cilat harton dokumentacionin teknik, po qe se për kryerjen e çdo pune, për hartimin e programit të investimit, ka në marrëdhënie pune së paku nga dy punëtorë me përgatitje shkollore superiore të degës, përkatësisht të drejtimit përkatës, me tre vjet përvojë pune në profesion dhe me provimin e dhënë profesional.

Organizata e punës së bashkuar, së cilës i është besuar hartimi i programit të investimit, hartimin e disa pjesëve të këtij programi mund t'ia cedojë organizatës tjetër të specializuar vetëm me pëlqimin dhe sipas kushteve që i cakton investuesi.

Mbi cedimin e hartimit të programit të investimit dhe të cedimeve konsalting lidhet kontrata me shkrim.

Neni 23

Shërbime konsalting në vështrim të këtij ligji konsiderohet kryerja e këtyre punëve:

— kërkimet paraprake lidhur me kushtet gjeologjike, gjeomekanike, gjeodezike dhe kushtet e tjera për ndërtimin e objektit;

— kërkimi i tregut në vend dhe në botën e jashtme dhe mundësia e plasmanit të produkteve e të shërbimeve;

— hartimi i analizave dhe i studimeve mbi produktivitetin e punës, organizimin e punës dhe efektet ekonomike në aplikimin e metodave shkencore në këtë lëmë;

— kërkimi dhe ndjekja e zhvillimit të teknologjisë;

— kërkimi i burimeve dhe i llojeve të energjisë dhe ekonomiciteti i përdorimit të tyre;

— hartimi i studimeve mbi rentabilitetin e investimeve të planifikuara;

— hartimi i treguesve ekonomikë e financiarë dhe kryerja e shërbimeve konsultative në kuadër të këtyre punëve;

— përpunimi i të dhënave dhe hartimi i programit të investimit;

— mbikëqyrja e hartimit të dokumentacionit, të cilin e hartojnë organizatat e tjera të punës së bashkuar;

— përgatitja e të dhënave dhe e dokumentacionit në procedurën e cedimit të punimeve;

— hartimi i detyrës së projektit;

— mbikëqyrja e zhvillimit të punimeve;

— ndjekja dhe harmonizimi i punës së të gjithë pjesëmarrësve në ndërtim;

— kontrolli i realizimit të programit të investimit dhe i konstruksionit financiar;

— dhënia e ndihmës profesionale në procedurën e pranimit-dorëzimit të objektit dhe të llogaritjes definitive;

— mbikëqyrja e funksionimit të objektit me rastin e lëshimit në punë provuese.

Punët nga paragrafi 1 i këtij neni organizata e punës së bashkuar mund t'i kryejë në qoftë se për kryerjen e secilës nga këto punë ka në marrëdhënie pune së paku nga dy punëtorë me përgatitje profesionale superiore të degës, përkatësisht të drejtimit të përkatës, me dy vjet përvojë pune në profesion dhe me provimin e dhënë profesional.

Evidencën e organizatave të punës së bashkuar, të cilat janë të regjistruara në regjistrin gjyqësor për kryerjen e shërbimeve konsalting, e mban Oda Ekonomike e Kosovës.

Organizata nga paragrafi 1 i këtij neni ka për detyrë që për regjistrimin e bërë të informojë Odën Ekonomike të Kosovës.

Neni 24

Investuesi, përkatësisht organizata e punës së bashkuar ose organizata e bashkësisë tjetër vetëqeverisëse, e cila e ka hartuar programin e investimit, përgjigjet për saktësinë e të dhënave që përmban programin, si dhe personat që kanë marrë pjesë në hartimin e tij.

Organizata nga paragrafi 1 i këtij neni përgjigjet edhe për pjesën e dokumentacionit që ia ka ceduar organizatës tjetër të punës së bashkuar.

Neni 25

Kur investuesi merr vendimin mbi ndërtimin e objektit, ka për detyrë të sigurojë zhvillimin profesional të të gjitha punëve të investuesit, e posaçërisht:

1. hartimin profesional të detyrës së projektit;

2. kontrollin e hartimit të dokumentacionit teknik;

3. sigurimin me kohë të kushteve për fillimin e punimeve të kontraktuara, sidomos të punimeve në rrilëvimin gjeodezik, të punimeve rreth blerjes dhe rregullimit të tokave;

4. koordinimin e punës së të gjithë pjesëmarrësve në ndërtimin e objektit dhe kryerjen me kohë të obligimeve reciproke;

5. kontrollin dhe mbikëqyrjen e shpenzimit të mjeteve investive,

6. kontrollin e realizimit të programit të investimit në pikëpamje të afateve — në të gjitha fazat e ndërtimit,

7. mbikëqyrjen e zhvillimit të punimeve në ndërtimin e objektit.

Punët nga paragrafi 1 i këtij neni investuesi mund t'i kryejë vetëm në qoftë se për kryerjen e secilës nga këto punë ka në marrëdhënie pune së paku

nga dy punëtorë me përgatitje profesionale superiore të degës, përkatësisht të drejtimit përkatës, me tre vjet përvojë pune në profesion dhe me provimin e dhënë profesional, ose që kryerjen e këtyre punëve t'ua besojë organizatave të tjera profesionale të punës së bashkuar, të cilat janë të regjistruara në regjistrin gjyqësor për kryerjen e këtyre punëve.

2. Dokumentacioni teknik

Neni 26

Dokumentacioni teknik, varësisht nga lloji dhe destinimi i objektit, përmban: projektet arkitektonike, projektet e pjesës ndërtimore të objektit, projektet e instalimeve, projektin teknologjik, projektin makinist dhe dokumentacionin tjetër me të cilin përcaktohen dhe përpunohen kushtet teknike, teknologjike, urbanistike, gjeodezike, sizmike, sanitare, të ekonomisë ujore, energjetike dhe kushtet kundër zjarrit, kushtet e mbrojtjes së ambientit jetësor dhe të mbrojtjes në punë, të mbrojtjes nga fatkeqësitë e natyrës, kushtet me rëndësi për mbrojtjen popullore, si dhe kushtet e tjera të përcaktuara me ligj dhe me dispozita të tjera.

Dokumentacioni teknik për ndërtimin e objektit, në kuadër të të cilit janë parashikuar me projekt strehimore me dy destinime ose instalime dhe impiante të destinuara për rast luftime, përmban edhe pjesën e dokumentacionit që ka të bëjë me këto objekte, si pjesë të veçantë. Hartimi i kësaj pjese të dokumentacionit u nënshtrohet dispozitave të posaçme me të cilat përcaktohen normativat teknike dhe kushtet e tjera të ndërtimit, të shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes.

Neni 27

Për ndërtimin e disa objekteve të llojit të njëjtë mund të hartohet dokumentacioni unik, të cilit patjetër i bashkangjiten pjesët e veçanta të dokumentacionit që kanë të bëjnë me specifikën e ndërtimit për secilin nga këto objekte dhe llojllojshmërinë e kushteve për ndërtimin e tyre.

Neni 28

Dokumentacioni teknik hartohet në pajtim me kushtet e përcaktuara me planin hapësinor, përkatësisht me planin urbanistik dhe varësisht nga lloji i objektit dhe destinimi e lokacioni i tij në pajtim me kushtet gjeologjike, fizike, energjetike, sanitare, të komunikacionit dhe të ekonomisë ujore, kushtet e mbrojtjes nga zjarri, të mbrojtjes në punë, të mbrojtjes së ambientit të jetës e të punës së njeriut, të mbrojtjes së të mirave kulturore dhe me kushtet e tjera të përcaktuara.

Kushtet për hartimin e dokumentacionit teknik i japin organet dhe organizatat e punës së bashkuar, të cilat janë caktuar me ligj ose me dispozitë tjetër që t'i përcaktojnë kushtet e ndërtimit të objektit në rajonin e caktuar, përkatësisht kushtet e ndërtimit të disa llojeve të objekteve.

Organi kompetent për dhënien e lejes për ndërtim ka për detyrë që investuesit me kërkesën e tij t'i japë informata se nga cilat organe dhe organizata duhet të merren kushtet e ndërtimit, varësisht nga lloji dhe destinimi i objektit dhe lokacioni i tij.

Kushtet e ndërtimit, të cilat japin organet ose organizatat e punës së bashkuar që kanë autorizime publike, i merr sipas detyrës zyrtare organi nga paragrafi 3 i këtij neni.

Kushtet e ndërtimit që kanë të bëjnë me çështjet e lokacionit e të kyçjeve komunale, si dhe me çështjet e tjera që kanë të bëjnë me kushtet e ndërtimit në rajonin e caktuar, i jep organi ose organizata e autorizuar, e cila jep kushtet urbanistike — teknike.

Organet dhe organizatat nga paragrafi 2 i këtij neni kanë për detyrë t'i japin kushtet e ndërtimit brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Neni 29

Investuesi ka për detyrë që hartimin e dokumentacionit teknik t'ia besojë organizatës së punës së bashkuar, e cila është e regjistruar në regjistrin gjyqësor për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Organizata e punës së bashkuar mund të hartojë dokumentacionin teknik po që se për hartimin e çdo pjese të dokumentacionit teknik, përkatësisht të çdo lloji të projektit që do ta hartojë ka në marrëdhënie pune së paku nga dy punëtorë me përgatitje profesionale superiore të degës, përkatësisht të drejtimit përkatës, me së paku dy vjet përvojë pune në profesion dhe me provimin e dhënë profesional.

Neni 30

Investuesi hartimin e dokumentacionit teknik mund t'ia besojë njëres ose disa organizatave të punës së bashkuar.

Hartimin e dokumentacionit teknik për tërë objektin investuesi mund t'ia besojë një organizate të punës së bashkuar po që se është e regjistruar në regjistrin gjyqësor për hartimin e të gjitha llojeve të projekteve që përbëjnë dokumentacionin teknik që cedohet ose të pjesës më të madhe të këtij dokumentacioni.

Organizata e punës së bashkuar, së cilës është besuar hartimi i dokumentacionit teknik, hartimin e tij nuk mund t'ia cedojë organizatës tjetër të punës së bashkuar.

Përjashtimisht nga dispozita e paragrafit 3 të këtij neni, organizata e punës së bashkuar së cilës i është besuar hartimi i dokumentacionit teknik për tërë objektin, hartimin e pjesëve të këtij dokumentacioni mund t'ia cedojë organizatës së punës së bashkuar me të cilën është lidhur marrëveshja vetëqeverisëse mbi bashkimin e punës dhe të mjeteve.

Hartimi i dokumentacionit teknik nuk mund t'i besohet organizatës së punës së bashkuar, e cila është e autorizuar t'i caktojë disa nga kushtet nga neni 28 paragrafi 2 i këtij ligji. Përjashtimisht, organizatat që kryerjnë punët komunale mund t'u besohet hartimi i dokumentacionit teknik për objektet që do t'i shfrytëzojnë për ushtrimin e veprimtarisë së vet themelore, po që se janë të regjistruara në regjistrin gjyqësor për kryerjen e këtyre punëve.

Në hartimin e dokumentacionit teknik nuk mund të marrë pjesë personi në organizatën e punës së bashkuar, përkatësisht në bashkësinë që është investuese ose në organin, përkatësisht organizatën nga neni 29 paragrafi 2 i këtij ligji, as personi që bën mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji.

Neni 31

Organizata e punës së bashkuar, e cila harton dokumentacionin teknik, ka për detyrë që me rastin e hartimit të këtij dokumentacioni:

1. t'u përmbahet dispozitave të ligjit dhe dispozitave të tjera, si dhe kushteve të përcaktuara për lokacionin e caktuar, standardeve të normativave teknike dhe normave të cilësisë aplikimi i të cilave është i detyrueshëm me rastin e hartimit të këtij dokumentacioni, si dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe eksploatimin e objekteve dhe t'i parashikojë masat e përcaktuara të mbrojtjes në punë, të mbrojtjes nga zjarri, të mbrojtjes nga zhurma, të mbrojtjes së ajrit dhe të ujit, të mbrojtjes nga fatkeqësitë e natyrës dhe kushteve të tjera të përcaktuara;

2. t'i sigurojë kushtet themelore ekonomiko-teknike, të cilat i ka përcaktuar investuesi me programin e investimit ose në mënyrë tjetër;

3. të parashikojë montimin e materialeve, të instalimeve, të impianteve dhe të pajisjeve me cilësitë përkatëse, si dhe ekzaminimin e tyre dhe t'i parashikojë zgjidhjet teknike racionale sipas kushteve teknike dhe kushteve të tjera të përcaktuara me programin e investimit.

Organizata nga paragrafi 1 i këtij neni ka për detyrë që dokumentacionin teknik ta hartojë në pajtim me kushtet që i kanë caktuar organet dhe organizatat e punës së bashkuar nga neni 28 paragrafi 2 i këtij ligji dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligj të veçantë.

Neni 32

Organizata e punës së bashkuar, e cila harton dokumentacionin teknik, ka për detyrë t'i përmbahet programit të investimit dhe detyrës së projektit të investuesit dhe është përgjegjëse për rregullsinë e dokumentacionit të hartuar, saktësinë e matjes, të specifikimit dhe të parallogarisë së punimeve, si dhe të zgjidhjeve teknike të parashikuara me projekt.

Në qoftë se organizata e punës së bashkuar gjatë hartimit të dokumentacionit teknik konstaton se zgjidhjet teknike dhe teknologjike të parashikuara me programin e investimit nuk u përgjigjen të arriturave shkencore dhe teknike bashkëkohore ose nuk janë oportune nga aspekti i efekteve ekonomike, apo nëse konstaton parregullsi të tjera, e ka për detyrë që për këtë ta njoftojë investuesin.

Neni 33

Organizata e punës së bashkuar, e cila e ka hartuar dokumentacionin teknik, e ka për detyrë të bëjë kontrollin e brendshëm të dokumentacionit të hartuar në mënyrën e përcaktuar me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës të organizatës.

Kontrolli i brendshëm përfshin verifikimin se a është hartuar dokumentacioni teknik sipas programit të investimit dhe detyrës së projektit të investuesit dhe a janë aplikuar dispozitat, standardet, normativat teknike dhe normat e cilësisë aplikimi i të cilave është i detyrueshëm për këtë lloj objektsh.

Me anë të kontrollit të brendshëm të dokumentacionit teknik për ndërtimin e objekteve të banimit verifikohet posaçërisht aplikimi i dispozitave teknike, i standardeve dhe i normativave teknike me të cilat përcaktohen kushtet sa i përket nxehësisë dhe mbrojtjes nga zëri, sipërfaqes e strukturës së njërive të banesave dhe kushteve të tjera për ndërtimin e objekteve të banimit.

Kontrollin e brendshëm mund ta bëjnë personat që janë në marrëdhënie pune në organizatën, e cila e ka hartuar dokumentacionin teknik, e kanë përgatitjen profesionale superiore të degës, përkatësisht të drejtimit përkatës, me tre vjet përvojë pune në profesion dhe me provimin e dhënë profesional.

Kontrollin e brendshëm nuk mund ta bëjnë personat që kanë punuar në hartimin e dokumentacionit teknik kontrolli i të cilit bëhet.

Neni 34

Organizata së cilës i është besuar hartimi i dokumentacionit teknik ka për detyrë t'i përmbahet afatit të përcaktuar me kontratë për hartimin e dokumentacionit teknik dhe nuk mund të kërkojë shtimin e çmimit të shërbimeve pas kalimit të këtij afati, përveç në rastet kur zgjatja e afatit është bërë me fajin e investuesit ose për shkaqe të tjera të përcaktuara shprehimisht me kontratë.

Organizata ka për detyrë të mbajë evidencën e dokumentacionit të hartuar teknik hartimi i të cilit është në vazhdim.

Neni 35

Dokumentacioni teknik, si dhe disa pjesë përbërëse të tij, përkatësisht projektet, duhet t'i nënshkru-

ajnë personat që si projektues përgjegjës kanë udhëhequr hartimin e tyre.

Projektues përgjegjës për dokumentacionin teknik mund të jetë personi që është në marrëdhënie pune me punëtorët në organizatën e punës së bashkuar, e cila harton dokumentacionin teknik, që ka përgatitjen profesionale superiore të degës, përkatësisht të drejtimit përkatës dhe së paku tre vjet përvojë pune në profesion dhe provimin e dhënë profesional.

Neni 36

Ndërtimi i objektit mund të bëhet edhe në bazë të dokumentacionit teknik të hartuar në botën e jashtme. Ky dokumentacion duhet të përkthehet dhe të vërtetohet nga organizata e punës së bashkuar, e cila e ka bërë kontrollin e tij.

Neni 37

Dokumentacionin teknik për ndërtimin e objektit mund ta hartojnë personat që i plotësojnë kushtet në pikëpamje të përgatitjes shkollore dhe përvojës së punës të përcaktuara me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës të organizatës.

Neni 38

Dokumentacioni teknik për objektet që ndërtohen me elemente montazhi sipas sistemit të ndërtimit industrial përmban projektet lidhur me mënyrën dhe kushtet e montimit të elementeve të gatshme të ndërtimit, dokumentacionin e prodhuesit që ka të bëjë me cilësinë, veçoritë teknike dhe karakteristikat e tjera të elementeve, si dhe dokumentacionin që ka të bëjë me kushtet e ndërtimit të objektit në lokacionin e caktuar.

Në qoftë se ndërtimi i objektit bëhet vetëm me montimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve ose instalimet, implantet dhe pajisjet montohen në objektin e ndërtuar, dokumentacionin teknik për zhvillimin e këtyre punimeve e përbën dokumentacionin i prodhuesit mbi mënyrën dhe kushtet e instalimit, përkatësisht të montimit të këtyre instalimeve, impianteve dhe pajisjeve.

3. Kontrolli teknik i dokumentacionit teknik

Neni 39

Dokumentacioni teknik nga neni 36 i këtij ligji dhe dokumentacioni teknik për ndërtimin e objekteve nga neni 41 paragrafi 3 i këtij ligji i shtrohen kontrollit teknik.

Kontrollin teknik mund ta bëjë organizata e punës së bashkuar, e cila është e regjistruar në regjistrin gjyqësor për hartimin e llojit përkatës të dokumentacionit teknik. Zgjedhjen e kësaj organizate e bën investuesi.

Organizata e punës së bashkuar, e cila e ka bërë kontrollin teknik, ka për detyrë të hartojë raportin e veçantë për kontrollin e bërë, që është pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik dhe të vërtetojë në këtë dokumentacion se është bërë kontrolli dhe se kontrollin e projektit përkatës e ka bërë personi, i cili ka përgatitjen profesionale superiore të degës, përkatësisht të drejtimit përkatës, me së paku pesë vjet përvojë pune në profesion dhe me provimin e dhënë profesionalë.

Në ushtrimin e kontrollit teknik nuk mund të marrin pjesë personat që janë në marrëdhënie pune në organizatën e punës së bashkuar, e cila e ka hartuar dokumentacionin teknik, personat që kanë marrë pjesë në hartimin e dokumentacionit, personat që janë në marrëdhënie pune në organizatën e punës së bashkuar, përkatësisht në bashkësinë e cila është investuese, si dhe personat që kryejnë punët e mbiqyrjes së zbatimit të dispozitave të këtij ligji.

Neni 40

Kontrolli teknik i dokumentacionit nënkupton verifikimin e rregullsisë së zbatimit të ligjeve e të dispozitave të tjera, të standardeve, të normativave teknike e të normave të cilësisë që aplikohen patjetër në ndërtimin e llojit të caktuar të objekteve, sidomos që kanë të bëjnë me stabilitetin e objektit dhe me ndërtimin e objekteve në rajonet sizmike, zgjidhjet teknike e teknologjike që i përmban projekti, si dhe me saktësinë e matjes e të parallogarisë dhe me specifikimin e punimeve dhe me vlerësimin real të tyre.

Kontrolli teknik e nënkupton edhe verifikimin e ekonomicitetit e të oportunitetit të ndërtimit të objektit dhe harmonizimin me programin e investuesit.

Kontrolli teknik i dokumentacionit të hartuar në botën e jashtme përbëhet nga verifikimi se a janë zbatuar dispozitat, masat dhe kushtet që u përgjigjen dispozitave, standardeve, masave teknike dhe normave jugosllave të cilësisë dhe kushteve për ndërtimin e objekteve të caktuara për këtë lloj. Kontrolli teknik i këtij dokumentacioni nënkupton edhe harmonizimin e masave e të njësive matëse dhe të treguesve të tjerë teknikë që zbatohen me rastin e zbatimit të dokumentacionit teknik.

Organizata e punës së bashkuar, e cila e ka bërë kontrollin teknik të dokumentacionit teknik, ka për detyrë që t'ia tërheqë vërejtjen investuesit për të gjitha parregullsitë që i përmban dokumentacioni dhe që në raportin e vet për kontrollin e bërë teknik të japë vlerësimin në vështrim të paragrafit 2 të këtij neni.

III. LEJA PËR NDËRTIM

Neni 41

Ndërtimi, përkatësisht rikonstruktimi i objektit mund të fillojë pasi të merret leja për ndërtim.

Lejen për ndërtimin e objektit e jep organi komunal i administratës kompetent për punët e ndërtimitarisë.

Përjashtimisht nga dispozita e paragrafit 2 të këtij neni, organi krahinor i administratës kompetent për punët e ndërtimitarisë e jep lejen për ndërtimin e:

1. trafostacioneve të largpërçuesve prej 220 e më shumë kilovatësh, hidrocentraleve, termocentraleve, ngrohtoreve, palestrave me përmasa mbi 25 metra, urave me përmasa mbi 30 metra, silosëve të drithit mbi 1.000 vagonë dhe silosëve për çimento mbi 300 vagonë, objekteve bërthamore, tyntarëve të lartë mbi 50 metra dhe pigrjeve mbi 25 metra, furnaltave, furnave metalurgjike dhe agregateve;

2. aeroporteve, autostradave dhe rrugëve magjistrale, hekurudhave, centraleve tranzite, njoyre dhe fundore, të gjitha rrugëve lidhëse dhe sistemeve bartëse ndërmjet këtyre stacioneve telefonike e telegrafike dhe stacioneve radio-difuzive e sistemeve të radio-relejeve;

3. objekteve të metalurgjisë me ngjyra, të metalurgjisë së zezë dhe të industrisë bazike e kimike;

4. hidrosistemeve me shumë destinime, digave të larta dhe të ulta me akumulime, sistemeve të mbrojtjes nga përmytjet, të rregullimit hidroekonomik të rajonit të pellgut të ujërrjedhave, sistemeve të furnizimit rajonal prej më se 300 ha, hurdhave të peshqëve me madhësi mbi 200 ha, ujësjellësve urbanë rajonale, përvojë rrjetit shpërndarës, cfrateve me kapacitet mbi 0,5 m³/s, stacioneve të pompimit me kapacitet mbi 0,5 m³/s, rezervuarëve të ujit me kapacitet mbi 0,5 m³/s;

5. largpërçuesve magjistrallë, shpërndarës dhe sjellës, shpërndarës dhe industrialë, rrjetit urban të gazit, stacioneve matëse — rajonale, stacioneve të kompresorëve, reparteve të mbushjes për gazin e lëngët dhe implanteve të kimisë bazike;

6. objekteve për kërkimin e lëndëve të para minerale në sipërfaqe dhe

7. objekteve të tjera të caktuara me ligj.

Neni 42

Organi kompetent për dhënien e lejes për ndërtim ka për detyrë të jepë lejen për ndërtim në qoftë se investuesi bashkangjet tërë dokumentacionin nga neni 46 paragrafi 1 i këtij ligji, e jo më vonë se brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Ndërtimi i objektit lejohet me aktvendim. Leja për ndërtim pushon të vlejë në qoftë se ndërtimi nuk fillon brenda afatit të caktuar në leje. Ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se gjashtë muaj as më i gjatë se një vit.

Neni 43

Ndërtimi i objektit, përkatësisht zhvillimi i disa punimeve mund të fillojë edhe pa leje, po qe se objekti ndërtohet, përkatësisht punimet zhvillohen mu para se të ndodhin ose gjatë kohës që ndodhin fatkeqësi të natyrës ose ngjarje të tjera të paparashikuara me qëllim që të pengohet ose të zvogëlohet efekti i tyre, si dhe të mënjanohej drejtpërdrejtë pasojat e dëmshme të këtyre fatkeqësive ose ngjarjeve. Leja për ndërtim nuk ka nevojë të merret as për ndërtimin e objekteve, përkatësisht zhvillimin e punimeve të tjera që kryhen në rast lufte ose rreziku të drejtpërdrejtë nga lufta.

Objektet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të mbesin si objekte të përhershme edhe pasi të pushojnë së ekzistuari rrethanat që kanë shkaktuar ndërtimin e tyre, po qe se i plotësojnë kushtet e caktuara urbanistike, teknike dhe kushtet e tjera të përcaktuara dhe në qoftë se investuesi në ndërkohë merr lejen për ndërtimin e tyre brenda afatit prej gjashtë muajsh pasi të pushojnë së ekzistuari rrethanat që kanë shkaktuar ndërtimin e tyre.

Në qoftë se investuesi brenda afatit të përcaktuar nuk merr lejen për ndërtimin e objektit nga paragrafi 1 i këtij neni, ka për detyrë që objektin e këtille ta rrëzojë ose ta heqë brenda afatit që e cakton organi komunal kompetent i administratës. Ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë.

Neni 44

Lejen për ndërtimin e objektit që ndërtohet në territorin e dy ose më shumë komunave e jep organi komunal kompetent i administratës, të cilit investuesi ia ka paraqitur kërkesën për dhënien e lejes me pëlqimin e organeve të tjera të administratës të komunave në territorin e të cilave do të ndërtohet objekti, po qe se me ligj nuk është caktuar organi tjetër.

Neni 45

Leja për ndërtim jepet për ndërtimin e tërë objektit investiv ose për një pjesë të këtij objekti që përbën një tërësi ekonomiko-teknike dhe si e tillë mund të shfrytëzohet në mënyrë të pavarur, po qe se objekti investiv ndërtohet sipas pjesëve.

Përjashtimisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, leja për ndërtim mund të jepet për një pjesë të objektit investiv, përkatësisht për zhvillimin e disa punimeve me këto kushte:

— që kjo pjesë e objektit, përkatësisht këto punime sipas dokumentacionit tekniko-projektues, të përbëjnë një tërësi teknike;

— që ndërtimi i tërë objektit investiv të zgjasë disa vjet;

— që dinamika e ndërtimit të tërë objektit investiv ta bëjë të mundshme ose ta kërkojë këtë.

Neni 46

Bashkë me kërkesën për dhënien e lejes për ndërtim investuesi ka për detyrë të paraqesë:

1. dokumentacionin teknik në pesë kopje;
2. vërtetimin e organit kompetent, përkatësisht të organizatës së autorizuar se dokumentacioni teknik është hartuar në pajtim me planin hapësinor, përkatësisht me planin urbanistik dhe me kushtet e përcaktuara urbanistike-teknike;
3. provën mbi të drejtën e shfrytëzimit ose të drejtën e servitutit mbi tokën në të cilën do të ndërtohet ose do të vendoset objekti, përkatësisht për rikonstruksionin e objektit — provën mbi të drejtën e shfrytëzimit ose të disponimit të objektit ose të pjesës së objektit rikonstruksionimi i të cilit bëhet;

4. provën se për ndërtimin e objektit, përkatësisht për zhvillimin e punimeve janë siguruar mjetet financiare në pajtim me dispozitat e veçanta;

5. Raporti mbi kontrollin e bërë teknik të dokumentacionit teknik për objektet e parashikuara me ligj dhe vërtetimin mbi rregullësinë e këtij dokumentacioni nga organizata e punës së bashkuar që e ka bërë kontrollin e tij.

Në qoftë se për ndërtimin e objektit me ligj ose me dispozitën e nxjerrë në bazë të ligjit janë përcaktuar kushte të veçanta (të ekonomisë ujore, komunale, të mbrojtjes nga zjarri, të mbrojtjes së të mirave kulturore, sanitare etj.), të cilat i përcaktojnë organet ose organizatat e autorizuar, përkatësisht në qoftë se me ligj është përcaktuar që të merret patjetër mendimi ose pëlqimi i këtyre organeve ose organizatave për disa lloje objektesh, organi kompetent ka për detyrë që nga këto organe ose organizata të marrë mendimin, përkatësisht pëlqimin e nevojshëm.

Neni 47

Në qoftë se në objektin që ndërtohet ose në objektin ekzistues zhvillohen punime që nuk konsiderohen rikonstruksionim në vështrim të dispozitës të nenit 5 paragrafi 5 të këtij ligji, investuesi ka për detyrë që për këto punime t'i paraqesë fletëparaqitje organit kompetent për dhënien e lejes për ndërtim jo më vonë se tetë ditë para fillimit të punimeve.

Bashkë me fletëparaqitjen nga paragrafi 1 i këtij neni investuesi ka për detyrë të paraqesë përshkrimin e punimeve dhe ndryshimet e plotësimet që bëhen në dokumentacionin teknik.

Në qoftë se organi nga paragrafi 1 i këtij neni konstaton se punimet e përmendura në fletëparaqitje konsiderohen rikonstruksionim i objektit dhe se për zhvillimin e tyre nga kushtet e përcaktuara me ligj nevojitet leja, për këtë do ta njoftojë menjëherë investuesin dhe do të caktojë vëllimin dhe llojin e dokumentacionit, të cilin investuesi ka për detyrë ta paraqesë bashkë me kërkesën.

Neni 48

Leja për ndërtimin e objektit investiv në bazë të dokumentacionit teknik të hartuar në botën e jashtme mund të jepet po që se dokumentacioni teknik u përgjigjet dispozitave të vendit, të cilat aplikohen për hartimin e dokumentacionit tekniko-projektues, në qoftë se dokumentacioni teknik është përkthyer dhe nëse është bërë kontrolli i këtij dokumentacioni.

Neni 49

Organi kompetent për dhënien e lejes për ndërtimin e objektit dhe investuesi, përkatësisht organi dhe organizata e punës së bashkuar në të cilën është bartur e drejta e shfrytëzimit, përkatësisht e qeverisjes së objektit, kanë për detyrë të ruajnë nga një ekzemplarë origjinal ose kompletin e shfrytëzuar në mënyrë të përcaktuar të dokumentacionit te-

knik në bazë të të cilit është ndërtuar, përkatësisht është rikonstruksionuar objekti, me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e këtij dokumentacioni të bëra gjatë ndërtimit ose shfrytëzimit të objektit për tërë kohën sa ekziston ky objekt.

Në qoftë se gjatë ekzistimit të objektit dëmtohet dokumentacioni teknik në bazë të të cilit ky objekt është ndërtuar, përkatësisht është rikonstruksionuar, organet ose organizatat e punës së bashkuar nga paragrafi 1 i këtij neni kanë për detyrë të bëjnë përtëritjen, përkatësisht plotësimin e pjesës së dëmtuar të dokumentacionit.

IV. NDËRTIMI I OBJEKTIT INVESTIV

1. Cedimi i ndërtimit të objektit

Neni 50

Ndërtimi i objektit mund t'i besohet organizatës së punës së bashkuar, e cila është e regjistruar në regjistrin gjyqësor për ndërtimin e këtij lloji të objektit, përkatësisht për zhvillimin e punimeve.

Organizata e punës së bashkuar mund t'i kryejë punët e ndërtimit të objektit në qoftë se për çdo lloj të punimeve që do t'i zhvillojë ka në marrëdhënie pune së paku dy punëtorë me përgatitje profesionale superiore dhe dy punëtorë me përgatitje të lartë ose të mesme shkollorë të degës, përkatësisht të drejtimit përkatës, më së paku tre vjet përvojë pune në profesion dhe me provimin e dhënë profesional.

Neni 51

Investuesi për nevoja të veta, pa u regjistruar në regjistrin gjyqësor, mund të ndërtojë objekte, përveç objekteve nga neni 40 paragrafi 3 i këtij ligji, përkatësisht të zhvillojë disa punime, po që se vlera paralogaritare e objektit në tërësi, përkatësisht e disa punimeve nuk e kalon shumën prej 5.000.000,00 dinarësh dhe në qoftë se ndërtimin e udhëheq personi, i cili është në marrëdhënie pune në organizatë, përkatësisht në bashkësinë që është investuese dhe i cili ka përgatitje profesionale superiore të degës, përkatësisht të drejtimit përkatës, së paku tre vjet përvojë pune në profesion dhe provimin e dhënë profesional.

Zhvillimin e disa punimeve në objekt (punimet ndërtimore-zejtare, të rregullimit të tokës, të instalimeve të brendshme) mund t'i udhëheq edhe personi që është në marrëdhënie pune në organizatë, përkatësisht në bashkësinë që është investuese dhe që ka përgatitjen e lartë ose të mesme shkollorë të degës, përkatësisht të drejtimit përkatës, së paku tre vjet përvojë pune në profesion dhe provimin e dhënë profesional.

Neni 52

Ndërtimi i objektit, përkatësisht zhvillimi i disa punimeve nuk mund t'i besohet organizatës së punës së bashkuar, e cila ka caktuar ndonjërin prej kushteve nga neni 28 paragrafi 2 i këtij ligji.

Përgjashtimisht nga dispozita e paragrafit 2 të këtij neni, ndërtimi i objektit, përkatësisht zhvillimi i disa punimeve mund t'i besohet organizatës së punës së bashkuar, e cila kryen punët komunale, po që se është fjala për objektin me të cilin kjo organizatë do të ushtrojë veprimtarinë e vet themelore dhe në qoftë se është e regjistruar në regjistrin gjyqësor për ndërtimin e këtij lloji të objektit.

Neni 53

Cedimi i ndërtimit të objektit, përkatësisht zhvillimi i disa punimeve bëhet me anë të ankandit publik me mbledhjen e ofertave ose me marrëveshje të drejtpërdrejtë.

Organi i qeverisjes, përkatësisht organi tjetër përkatës i investuesit me aktin e përgjithshëm cakton më hollësisht mënyrën dhe kushtet e cedimit të ndërtimit të objektit, përkatësisht të zhvillimit të disa punimeve varësisht nga lloji, ndërlukueshmëria, vlera dhe kushtet e tjera të tyre.

Për cedimin e ndërtimit të objektit dhe zgjedhjen e organizatës së punës së bashkuar, e cila do t'i zhvillojë punimet, vendosin punëtorët në mënyrën e përcaktuar me statut, në pajtim me ligjin.

Organizatës së punës së bashkuar, së cilës i besohet ndërtimi i objektit, mund t'i cedohet edhe hartimi i dokumentacionit me të cilin përpunohen kushtet dhe hollësitë e zhvillimit të punimeve, si dhe dokumentacioni i organizimit të ndërtimit.

Neni 54

Ankandi publik bëhet me paraqitjen e ofertave me shkrim nga ana e pjesëmarrësve në ankandin publik në bazë të shpalljes për mbajtjen e ankandit publik.

Ndërtimin e objektit, përkatësisht zhvillimin e punimeve të tjera investuesi ia beson organizatës së punës së bashkuar oferta e së cilës në ankandin publik është më e volitshme.

Ofertë më e volitshme konsiderohet oferta që është më e volitshme në pikëpamje të të gjitha kushteve të përmendura në shpalljen për mbajtjen e ankandit publik.

Me rastin e përcaktimit të kushteve për cedimin e ndërtimit të objektit, përkatësisht zhvillimin e disa punimeve me anë të ankandit publik, investuesi ka për detyrë të sigurojë pjesëmarrjen e barabartë të të gjithë pjesëmarrësve të interesuar në ankandin publik.

Investuesi ka për detyrë që në aktin mbi pranimin e ofertës t'i përmend arsyet për të cilat këtë ofertë e ka vlerësuar si më të volitshme dhe këtë akt t'ua dërgojë të gjithë pjesëmarrësve në ankandin publik brenda afatit të caktuar në shpalljen për ankandin publik. Brenda po këtij afati investuesi ka për detyrë t'i informojë pjesëmarrësit për ankandin publik edhe po që se ankandi publik nuk ka pasur sukses.

Në qoftë se pjesëmarrësi në ankandin publik konsideron se është shkelur procedura ose zgjedhja nuk është bërë sipas kushteve të dhëna në shpalljen për ankandin publik, ka të drejtë kundërshtimi organit të caktuar me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës të investuesit, i cili ka për detyrë të shqyrtojë kundërshtimin dhe për këtë ta informojë paraqitësin e kundërshtimit.

Kur investues të objektit janë disa persona juridikë-shoqëror, paraqitësi i ofertës më të volitshme zgjedhet me marrëveshje.

Neni 55

Investuesi rregullon kushtet për cedimin e ndërtimit të objektit investiv ose të disa punimeve.

Me rastin e përcaktimit të kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni investuesi ka për detyrë të sigurojë pjesëmarrjen e barabartë në ankandin publik, përkatësisht në konkursin publik mbi përshtatshmërinë e kryesve të punimeve të të gjitha organizatave të punës së bashkuar të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë në të cilën bëjnë pjesë punimet që janë objekt cedimi.

Neni 56

Shpallja për ankandin publik publikohet në „Gazetën Zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

Në shpalljen për mbajtjen e ankandit publik ose të konkursit mbi përshtatshmërinë e kryesve të punimeve investuesi ka për detyrë të theksojë posaçërisht se cilat punime cedohen, me çfarë kushtesh

cedohen, vendin e zhvillimit të këtyre punimeve, vlerën orientuese të këtyre punimeve, afatin e kryerjes së tyre, afatin e paraqitjes së ofertave, afatin brenda të cilit do t'i informojë pjesëmarrësit se a ka pranuar dhe cilën ofertë e ka pranuar në procedurën e ankandit publik, përkatësisht me rastin e mbledhjes së ofertave cilën ofertë e ka vlerësuar të përshtatshme për ndërtimin e objektit investiv, përkatësisht për zhvillimin e punimeve dhe kushtet sipas të cilave do të konsiderohet se ankandi publik, përkatësisht mbledhja e ofertave ka pasur sukses.

Neni 57

Konkursi mbi përshtatshmërinë e kryesve të punimeve zbatohet në bazë të fletëparaqitjeve që i paraqesin pjesëmarrësit në konkursin mbi përshtatshmërinë e kryesve të punimeve, e që përmban:

1. provat mbi aftësinë teknike, kadrovike, dhe profesionale për ndërtimin e objektit investiv,
2. provat mbi kushtet e tjera që i kërkon investuesi sipas specifikave të ndërtimit.

Neni 58

Cedimi i ndërtimit të objektit investiv me anë të ankandit publik bëhet në bazë të ofertave, të cilat pjesëmarrësi i paraqesin me shkrim.

Cedimi i ndërtimit të objektit investiv me anë të mbledhjes së ofertave që mbledhen vetëm nga pjesëmarrësit në konkursin mbi përshtatshmërinë e kryesve të punimeve, të cilët me vendimin e investuesit janë shpallur të përshtatshëm për ndërtimin e objektit investiv.

Ofertën për ndërtimin e objektit investiv e paraqesin bashkërisht organizatat e punës së bashkuar, të cilat kanë lidhur marrëveshjen vetëqeverisëse mbi bashkimin e punës dhe të mjeteve për ndërtimin e përbashkët të objektit investiv, përkatësisht marrëveshjen vetëqeverisëse mbi bazat për bashkimin e punës dhe të mjeteve për ndërtimin e përbashkët të objektit investiv.

Ndërtimi i objektit investiv i besohet organizatës së punës së bashkuar oferta e së cilës është më e volitshme, po që se në kushtet për cedimin e ndërtimit të objektit investiv nuk është caktuar ndryshe.

Investuesi ka për detyrë që brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e hapjes së ofertave të përcaktojë ofertën më të volitshme, që në aktin mbi pranimin e ofertave t'i theksojë arsyet për të cilat këtë ofertë e ka vlerësuar si më të volitshme dhe që këtë akt t'ua dërgojë të gjithë pjesëmarrësve në ankandin publik, përkatësisht në mbledhjen e ofertave.

Neni 59

Investuesi përcakton se a ka pasur sukses ankandin publik, përkatësisht mbledhja e ofertave.

Konsiderohet se ankandi publik, përkatësisht mbledhja e ofertave nuk ka pasur sukses në qoftë se asnjë ofertë e paraqitur në ankandin publik, përkatësisht në mbledhjen e ofertave nuk i plotëson të gjitha kushtet, që i ka përcaktuar investuesi në bazë të nenit 60 paragrafi 1 të këtij ligji.

Në qoftë se konstaton se ankandi publik, përkatësisht mbledhja e ofertave nuk ka pasur sukses, investuesi ka për detyrë që për këtë t'i njoftojë të gjithë pjesëmarrësit në ankandin publik, përkatësisht në mbledhjen e ofertave brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e hapjes së ofertave, përkatësisht të fletëparaqitjeve.

Neni 60

Cedimi i ndërtimit të objektit, përkatësisht i zhvillimit të punimeve me anë të marrëveshjes së drejtpërdrejtë mund të bëhet:

a) në qoftë se vlera paralogaritave e objektit në tërësi ose e punimeve që cedohen nuk kalon shumën prej 20.000.000 dinarësh;

b) në qoftë se as ankandit publik i përsëritur, përkatësisht mbledhja e përsëritur e 4 ofertave nuk ka pasur sukses;

c) në qoftë se është fjala për kryerjen e punimeve të ngutshme para dhe pas fatkeqësi të natyrës ose të ngjarjeve të tjera të paparashikuara.

Enti Krahinor i Statistikës në fillim të çdo viti kalendarik përcakton shumën e rivalorizuar nga paragrafi 1 pika a) të këtij neni, në bazë të indeksit të shtimit të çmimeve të elementeve të ndërtimit dhe të elementeve të tjera për ndërtimin e objekteve, të cilat i shpall Enti Federativ i Statistikës.

Neni 61

Dispozitat e këtij ligji mbi cedimin e ndërtimit të objektit, përkatësisht të zhvillimit të disa punimeve kanë të bëjnë edhe me cedimin e hartimit të dokumentacionit teknik për dhënien e lejes për ndërtim.

Cedimi i hartimit të dokumentacionit teknik me anë të marrëveshjes së drejtpërdrejtë mund të bëhet sipas kushtit të përcaktuar për cedimin e ndërtimit të objektit nga neni 60 i këtij ligji.

Për hartimin e projektidesë së objektit investuesi ka për detyrë të shpall konkursin publik. Në konkurs mund të marrë pjesë çdo person.

Investuesi ka për detyrë që me aktin e përgjithshëm nga neni 53 paragrafi 2 i këtij ligji të caktojë mënyrën dhe kushtet e cedimit të hartimit të dokumentacionit teknik.

Neni 62

Investuesi përkatësisht kryesi i punimeve disa punime në objekt mund t'ia besojë organizatës me kontratë të punës së bashkuar ose kooperativës zëjtare që është e regjistruar në regjistrin për kryerjen e këtyre punëve ose një zëjtari që ka lejen për ushtrimin e veprimtarisë në të cilën bëjnë pjesë këto punime.

Cedimi mund të bëhet vetëm me anë të ankandit publik.

Investuesi përkatësisht kryesi i punimeve me aktin e përgjithshëm përcakton kushtet dhe mënyrën e cedimit të disa punimeve organizatës me kontratë të punës së bashkuar, kooperativës zëjtare, përkatësisht zëjtarit të pavarur. Vendimin mbi cedimin e këtyre punimeve e merr organi i qeverisjes ose organi tjetër përkatës i investuesit. Në bazë të këtij vendimi lidhet kontrata me shkrim.

Neni 63

Investuesi dhe organizata e punës së bashkuar së cilës i është besuar ndërtimi i objektit përkatësisht zhvillimi i punimeve, lidhin kontratë me shkrim mbi ndërtimin.

Kontrata mbi ndërtimin lidhet në pajtim me dispozitat e ligjit me të cilat janë rregulluar marrëdhëniet e detyrimeve.

Neni 64

Organizata e punës së bashkuar së cilës i është besuar ndërtimi i objektit, përkatësisht zhvillimi i punimeve ndërtimin e këtij objekti nuk mund t'ia cedojë organizatës tjetër të punës së bashkuar.

Nuk konsiderohet, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, cedim i punimeve organizatës tjetër në qoftë se në procedurën e ankandit publik një organizatë ka dhënë ofertë në të cilën janë caktuar të gjithë kryesit e punimeve, të cilët me këtë organizatë do të marrin pjesë në zhvillimin e punimeve në bazë të marrëveshjes mbi bashkimin e përherëshëm të punës dhe të mjeteve dhe pjesëmarrjen e përbashkët në punët me interes të përbashkët.

Neni 65

Investuesi të gjitha punët lidhur me ndërtimin e objektit, përkatësisht zhvillimin e punimeve mund t'ia besojë një organizate të punës së bashkuar, po që se kjo organizatë është regjistruar në regjistrin gjyqësor për kryerjen e punëve të inxhinieringut.

Punë të inxhinieringut në vështrim të këtij ligji konsiderohet kryerja e punëve të hartimit të dokumentacionit teknik, ndërtimi i objektit, blerja dhe montimi i aparateve, i impianteve dhe i pajisjes, lëshimi i objektit në punë dhe aftësimi i kuadrit profesional që do të udhëheqë objektin.

Punët e inxhinieringut mund t'i marrë përsipër vetëm organizata që në kuadër të vet ka organizata themelore, përkatësisht organizata punuese të regjistruara në regjistrin gjyqësor për kryerjen e të gjitha punëve që cedohen në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni dhe që me marrëveshjen vetëqeverisëse me këto organizata është autorizuar t'i marrë përsipër punët që janë objekt cedimi.

2. Ndërtimi dhe udhëheqja e ndërtimit

Neni 66

Ndërtimi i objektit, përkatësisht zhvillimi i punimeve bëhet sipas dokumentacionit teknik në bazë të të cilit është lëshuar leja për ndërtim.

Në qoftë se gjatë ndërtimit të një objekti duhet të zhvillohen punime që nuk janë parashikuar me dokumentacionin teknik në bazë të të cilit është lëshuar leja për ndërtim ose me të cilat ndryshohen kushtet tekniko-urbanistike, ose kushtet e tjera të ndërtimit, investuesi ka për detyrë të paraqesë menjëherë kërkesën për dhënien e lejes për ndërtim sipas dokumentacionit të ndryshuar teknik.

Organizata e punës së bashkuar, e cila ndërton objektin, përkatësisht kryen punimet, nuk mund t'i fillojë punimet pa projektet që janë pjesë përbërëse të dokumentacionit teknik nga neni 46 i këtij ligji.

Neni 67

Organizata e punës së bashkuar, e cila ndërton objektin investiv ose zhvillon punimet, ka për detyrë të njoftojë organin që e ka dhënë lejen për ndërtimin e këtij objekti, organet që i kryejnë punët e inspektimit në ndërtimin e këtij objekti dhe Shërbimin e Kontabilitetit Shoqëror për ditën e fillimit të punimeve në ndërtimin e objektit investiv, përkatësisht të zhvillimit të punimeve jo më vonë se tetë ditë para fillimit.

Neni 68

Organizata e punës së bashkuar, e cila ndërton objektin investiv, me aktin e përgjithshëm vetëqeverisëse përcakton kushtet që duhet t'i plotësojnë punëtorët, të cilët udhëheqin ndërtimin e llojit të caktuar të objekteve investive, përkatësisht zhvillimin e punimeve.

Ndërtimin e objekteve të ndërlikuara dhe specifike, varësisht nga ndërlikueshmëria dhe specifika e objektit dhe nga përvoja e punëtorëve në ndërtimin e objekteve të këtilla, mund ta udhëheqë inxhinieri i diplomuar i degës përkatëse me së paku tre vjet përvojë pune në ndërtimin e objekteve të këtilla dhe me provimin e dhënë profesional ose inxhinieri i degës përkatëse me pesë vjet përvojë pune në ndërtimin e objekteve të këtilla dhe me provimin e dhënë profesional.

Neni 69

Organizata e punës së bashkuar, e cila ndërton objektin investiv, ka për detyrë që:

1. punimet t'i zhvillojë sipas dispozitave teknike, normativave dhe standardeve të detyrueshme që vlejën për ndërtimin e këtij lloji të objektit investiv,

kurse për banesa dhe ndërtesa banimi në ndërtimin shoqërisht të orientuar të banesave — edhe sipas kushteve unike për projektimin dhe ndërtimin e banesave dhe të ndërtesave të banimit në ndërtimin shoqërisht të orientuar të banesave;

2. të përdorë material ndërtimi që u përgjigjet standardeve të përcaktuara, përkatësisht që është i pajisur me atestin (vërtetimin) e cilësisë të dhënë nga organizata e regjistruar për veprimtarinë e ekzaminimit të këtij materiali, po që se për këtë material nuk ka standarde;

3. të marrë me kohë masa për sigurinë e objektit investiv dhe të punimeve, të pajisjes dhe të materialit investiv, të punëtorëve, të kalimtarëve, të komunikacionit dhe të objekteve fqinje;

4. me anë të kontrollit të brendshëm të sigurojë që punimet të zhvillohen në pajtim me dispozitat e pikave 1 deri 4 të këtij neni.

Neni 70

Për sigurimin e të dhënave për rrjedhën dhe mënyrën e ndërtimit të objektit investiv në tërësi dhe në disa faza, organizata e punës së bashkuar e cila ndërton objektin investiv ka për detyrë të mbajë ditarin e ndërtimit dhe librin e inspektimit.

Në ditarin e ndërtimit shënohen të gjitha të dhënat për zhvillimin e ndërtimit të objektit investiv dhe kushtet natyrore e kushtet e tjera në të cilat janë zhvilluar punimet, e që kanë ndikim në cilësinë e punimeve dhe sigurinë e objektit.

Në librin e inspektimit shënohen konstatimet e inspeksionit lidhur me zhvillimin e punimeve në objektin investiv dhe konstatimet lidhur me aplikimin e normave dhe standardeve teknike.

Organi krahinor i administratës kompetent për punët e ndërtimitarisë përcakton formularin dhe mënyrën e mbajtjes së ditarit të ndërtimit dhe të librit të inspektimit.

Librat nga paragrafi 1 i këtij neni parashikohen të mbahen veçmas për çdo objekt investiv që ndërtohet. Organizata e punës së bashkuar, e cila në të njëjtin vend ndërton disa objekte që përbëjnë një tërësi teknike dhe funksionale, për të gjitha objektet mund të mbajë një ditar ndërtimi dhe një libër inspektimi.

3. Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të objektit

Neni 71

Gjatë ndërtimit të objektit, përkatësisht gjatë zhvillimit të punimeve investuesi ka për detyrë të sigurojë mbikëqyrjen profesionale.

Mbikëqyrja profesionale nga paragrafi 1 i këtij neni nënkupton sidomos: verifikimin e cilësisë së zhvillimit të punimeve dhe të aplikimit të dispozitave, të standardeve, të normativave teknike dhe të normave të cilësisë; kontrollin e materialit që montohet; kontrollin se a bëhet ndërtimi sipas dokumentacionit teknik në bazë të të cilit është lejuar ndërtimi i objektit; verifikimin e saktësisë së shënimit të objektit, të ndjekjes së dinamikës së ndërtimit sipas etapave, të realizimit të konstruksionit financiar të parashikuar me programin e investimit; kujdesin që të respektohen afatet e kontraktuara për zhvillimin e punimeve dhe a vepron organizata që ndërton objektin në pajtim me ligjin dhe dispozitat e tjera.

Personi që bën mbikëqyrjen profesionale ka për detyrë që të informojë me kohë investuesin për të gjitha të metat që i konstaton gjatë ndërtimit të objektit.

Organi krahinor i administratës kompetente për punët e ndërtimitarisë do të nxjerrë dispozita më të hollësishme për mënyrën e ushtrimit të mbikëqyrjes profesionale të ndërtimit të objektit.

Neni 72

Investuesi mbikëqyrjen profesionale të ndërtimit të objektit mund ta bëjë vet ose ushtrimin e kësaj mbikëqyrjeje t'ia besojë organizatës së punës së bashkuar, e cila është e regjistruar në regjistrin gjyqësor për kryerjen e punëve të projektimit për këtë lloj objekti, përkatësisht për këtë lloj punimesh ose organizatës së punës së bashkuar për kryerjen e shërbimeve konsalting.

Investuesi dhe organizata e punës së bashkuar së cilës i është besuar mbikëqyrja e punës profesionale, për këtë lidhin kontratë me shkrim. Kontrata përmban sidomos dispozita mbi përgjegjësinë e organizatës që bën mbikëqyrjen, për dëmin në rast se nuk merr masa për mënjanimin e të metave që i konstaton; përgjegjësinë për mosinformimin me kohë të investuesit për ndryshimet që ndodhin gjatë ndërtimit e që mund të ndikojnë në respektimin e afateve, çmimin, cilësinë ose kushtet e tjera të ndërtimit; autorizimin e organizatës që bën mbikëqyrjen profesionale për marrjen e masave të ngutshme; obligimet e investuesit për kryerjen me kohë të punimeve investive dhe dispozita të tjera me të cilat rregullohen marrëdhëniet reciproke.

Neni 73

Mbikëqyrjen profesionale të ndërtimit të objektit mund ta bëjë personi, i cili është në marrëdhënie pune në organizatën e punës së bashkuar që është investuese ose në organizatën së cilës investuesi ia ka besuar ushtrimin e mbikëqyrjes dhe që ka përgatitje profesionale superiore të degës përkatësisht të drejtimit përkatës, tre vjet përvojë pune në profesion dhe provimin e dhënë profesional.

V. HARTIMI I DOKUMENTACIONIT TEKNIK DHE NDËRTIMI I OBJEKTIT NË RAJONIN QË GODITET NGA TËRMETET

Neni 74

Me rastin e hartimit të dokumentacionit teknik dhe ndërtimit të objekteve investive në rajonet që goditen nga tërmetet, aplikohen kushtet që janë përcaktuar me hartën e mikroregjionalizimit të termeteve, si dhe dispozitave teknike dhe dispozitat e tjera me të cilat rregullohet ndërtimi i objektit në rajonin që goditet nga tërmetet.

Harta e mikroregjionalizimit të termeteve përmban të dhënat dhe kushtet mbi ndikimet sizmike, të cilat aplikohen me rastin e llogaritjes së stabilitetit të objektit.

Neni 75

Rajon që goditet nga tërmetet në vështrim të këtij ligji konsiderohet rajoni me forcë termeti prej së paku shtatë shkallës të Merkali-Kankan — Zibergut, të përcaktuara me hartën nga neni 74 i këtij ligji.

Neni 76

Kuvendi i komunës, territori i së cilës gjendet në rajonin që goditet nga tërmetet, të përcaktuar me hartën e regjionalizimit të termeteve të krahinës, ka për detyrë t'i sigurojë hartat e mikroregjionalizimit të termeteve për të gjitha pjesët e territorit që janë përfshirë me planin hapësinor, përkatësisht me planin urbanistik.

Për objektet nga neni 41 paragrafi 3 i këtij ligji investuesit kanë për detyrë që para hartimit të dokumentacionit teknik të sigurojnë hartimin e hartës së mikroregjionalizimit të termeteve për atë pjesë të tokës që e përfshin objekti.

Organi krahinor i administratës kompetent për punët e ndërtimitarisë do të nxjerrë dispozita më të

hollësishme për përmbajtjen e hartës së mikroregjionalizimit të termeteve, si dhe për mënyrën e sigurimit të hartimit të këtyre hartave.

VI. KONTROLLI TEKNIK DHE LEJA PËR PËRDORIMIN E OBJEKTIT TË NDËRTUAR INVESTIV

Neni 77

Pas kryerjes së ndërtimit të objektit investiv ose të një pjese të objektit që përbën një tërësi ekonomiko-teknike dhe si e tillë mund të shfrytëzohet në mënyrë të pavarur, e para se të fillojë të shfrytëzohet, përkatësisht të lëshohet në punë, do të bëhet kontrolli teknik i objektit të ndërtuar, përkatësisht i pjesës së tij me qëllim që të verifikohet rregullsia teknike e tij.

Kontrolli teknik i objektit investiv, sipas natyrës së objektit investiv, përfshin kontrollin teknik të punimeve të ndërtimit, kontrollin teknik të instalimeve dhe kontrollin teknik të pajisjeve e të impianteve.

Neni 78

Kontrollin teknik e bën komisioni profesional, të cilin me kërkesën e investuesit dhe të kryesit të punimeve e formon organi i administratës, i cili e ka dhënë lejen për ndërtim.

Kryerja e kontrollit teknik i besohet organizatës së punës së bashkuar, e cila është e regjistruar në regjistrin gjyqësor për kryerjen e punëve të ekspertizës në lëmin e ndërtimit ose organizatës së punës së bashkuar, e cila është e regjistruar në regjistrin gjyqësor për hartimin e llojit përkatës të dokumentacionit teknik, përkatësisht për ndërtimin e këtij lloji të objekteve, me përjashtim të organizatës që ka marrë pjesë në hartimin e dokumentacionit teknik ose në ndërtimin e këtij objekti.

Në qoftë se kryerja e kontrollit teknik nuk i besohet organizatës nga paragrafi 2 i këtij neni, organi kompetent i administratës për kryerjen e kontrollit teknik të disa llojeve të objekteve mund të formojë komision nga personat profesionistë zgjedhjen e të cilëve e bën sipas mënyrës dhe procedurës për caktimin e ekspertëve në procedurën administrative.

Shpenzimet e kontrollit teknik i heq investuesi ose kryesi i punimeve, po që se kjo është parashikuar me kontratë.

Shpenzimet e punës së komisionit të kontrollit teknik caktohen sipas kriterëve dhe elementeve për caktimin e shpërblyerjes për ekspertë në procedurën administrative të përcaktuar me dispozita të veçanta.

Organi krahnor i administratës kompetente për punët e ndërtimit do të nxjerr dispozita me të hollësishme për kryerjen e kontrollit teknik të objekteve.

Neni 79

Në komisionin e kontrollit teknik mund të caktohet personi që i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj për hartimin e dokumentacionit teknik për objektin kontrolli i të cilit bëhet.

Në komisionin e kontrollit teknik nuk mund të caktohet personi i cili është në marrëdhënie pune në organizatën e punës së bashkuar ose në organizatën dhe bashkësinë tjetër vetëqeverisëse që është investuese ose në organizatën e punës së bashkuar, e cila e ka hartuar dokumentacionin teknik ose ka qenë kryese e punimeve, si dhe personi që ka bërë mbikëqyrjen profesionale të ndërtimit të objektit.

Në punën e komisionit mund të marrë pjesë edhe përfaqësuesi i organizatës së punës së bashkuar, e cila e ka hartuar dokumentacionin teknik dhe i organizatës së cilës objekti do t'i dorëzohet për qeverisje e mirëmbajtje ose për shfrytëzim.

Neni 80

Me anë të kontrollit teknik përcaktohet se a është ndërtuar objekti investiv në pajtim me dokumentacionin teknik mbi stabilitetin e objektit, sigurinë nga zjarri, sigurinë e jetës e të shëndetit të njerëzve, të komunikacionit dhe të objekteve fqinje në pajtim me dispozitat, normativat dhe standardet aplikimi i të cilave me rastin e ndërtimit të objektit të këtij lloji është i detyrueshëm, si dhe me kushtet e përcaktuara për ndërtimin e objektit investiv në tokën e caktuar; a janë marrë masat e përcaktuara me të cilat do të pengohet, përkatësisht të reduktohet në masën më të vogël dëmi, të cilin objekti investiv me ekzistimin përkatësisht me shfrytëzimin e vet mund t'ia shkaktojë rrethinës së vet dhe a është bërë rievimi gjeodezik i objektit.

Neni 81

Në qoftë se me rastin e kontrollit teknik konstatohet se të metat e objektit të ndërtuar investiv nuk mund të mënjanohen ose ekziston rreziku i pamjaftueshëm për stabilitetin e objektit ose për jetën e shëndetin e njerëzve, komunikacionin ose objektet fqinje, organi kompetent për kryerjen e kontrollit teknik do të marrë aktvendim që objekti investiv të rrëzohet ose të hiqet.

Neni 82

Leja për përdorim mund të jepet kur të bëhet kontrolli teknik i objektit, përkatësisht i pjesës së tij me qëllim që të konstatohet se a është i përshatshëm për përdorim. Kontrolli teknik duhet të fillojë jo më vonë se brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Objekti është i përshatshëm për përdorim:

1. në qoftë se mund të shfrytëzohet në pajtim me destinimin e vet;

2. në qoftë se nuk vë në rrezik jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe në qoftë se janë plotësuar kushtet e veçanta të caktuara me dispozitat për mbrojtjen e ambientit të jetës e të punës së njeriut;

3. në qoftë se nuk rrezikon shfrytëzimin e objekteve fqinje;

4. në qoftë se janë plotësuar kushtet e sigurisë nga zjarri dhe të sigurisë së komunikacionit, si dhe kushtet e mbrojtjes në punë;

5. në qoftë se objekti është ndërtuar në pajtim me dokumentacionin teknik në bazë të të cilit është dhënë leja për ndërtim;

6. në qoftë se është bërë rievimi gjeodezik i objektit;

7. në qoftë se janë kryer punimet rreth objektit me të cilat sigurohet shfrytëzimi pa pengesë i objektit;

8. në qoftë se janë plotësuar kushtet me rëndësi për mbrojtjen popullore dhe vetëmbrojtjen shoqërore;

9. në qoftë se janë plotësuar kushtet e tjera të përcaktuara me ligj.

Kontrolli teknik i objektit, sipas natyrës së objektit, përfshinë kontrollin e punimeve të ndërtimit dhe të punimeve ndërtimore-zejtare, të instalimeve, të pajisjeve, të impianteve e të aparateve dhe rregullimin e terrenit rreth objektit.

Kontrolli teknik i objektit që ndërtohet sipas etapave, mund të bëhet sipas këtyre etapave, e sidomos në rastet kur me zhvillimin e mëtejshëm të punimeve punimet e mëparshme bëhen të papërshatshme ose kur punimet i vazhdon kryesi tjetër i punimeve. Në këtë rast merret edhe aktvendimi që ka karakter të aktvendimit të përkohshëm.

Neni 83

Organi i administratës, i cili e ka dhënë lejen për ndërtim, ka për detyrë të jepë lejen për përdorim

rim brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së konstatimit të komisionit me të cilin është vërtetuar se objekti është i përshtatshëm për përdorim. Në qoftë se bëhet kontrolli teknik i objektit, përshtatshmëria për shfrytëzimin e të cilit mund të përcaktohet vetëm pas ekzaminimeve të bëra provuese, organi kompetent me propozimin e komisionit mund të lejojë lëshimin e objektit në punë provuese. Aktvendimi me të cilin lejohet lëshimi i objektit në punë provuese duhet të përmbajë afatin deri kur duhet të kryhen ekzaminimet dhe obligimin e investuesit që pas kalimit të afatit të marrë lejen për shfrytëzimin e objektit.

Organi nga paragrafi 1 i këtij neni mund të refuzojë të japë lejen për përdorimin e objektit, po qe se investuesi nuk i ka hequr objektet që janë montuar në kuadër të punimeve paraprake e përgatitore apo nëse nuk i ka plotësuar kushtet që janë përcaktuar me lejen për ndërtim dhe me dispozita të tjera me të cilat përcaktohet përshtatshmëria e objektit për shfrytëzim.

Neni 84

Ankesën kundër aktvendimit që është marrë në bazë të neneve 81 e 83 të këtij ligji investuesi ose kryesi i punimeve mund t'ia paraqesë organit krahnor të administratës kompetente për punët e ndërtimitarisë.

VII. PROVIMI PROFESIONAL

Neni 85

Provimi profesional për punët e parashikuara me këtë ligj jepet sipas programit të provimit profesional para komisionit, të cilin e formon dhe anëtarët e tij i emëron organi krahnor i administratës kompetent për punët e ndërtimitarisë.

Organi i administratës kompetent për punët e ndërtimitarisë përcakton programin e provimit profesional dhe mënyrën e dhënies së provimit.

Shpenzimet e dhënies së provimit profesional i heq kandidati, po qe se këto shpenzime nuk i heq organizata e punës së bashkuar, e cila e dërgon punëtorin për të dhënë provimin profesional.

VIII. MBIKËQYRJA INSPEKTUESE

Neni 86

Mbikëqyrjen inspektuese të zbatimit të këtij ligji dhe të dispozitave të nxjerra për zbatimin e tij, të aplikimit të standardeve, të normativave teknike dhe të normave të cilësisë, aplikimi i të cilave është i detyrueshëm me rastin e ndërtimit të objekteve, e bën organi i administratës kompetente për punët e inspeksionit përkatës në mënyrën dhe sipas procedurës së përcaktuar me ligj të veçantë.

Mbikëqyrja në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni nënkupton posaçërisht: verifikimin e plotësisë së kushteve të përcaktuara për organizatat e punës së bashkuar që i kryejnë punët e hartimit të dokumentacionit teknik, organizatat që i kryejnë shërbimet konsalting ose që i ndërtojnë objektet; verifikimin e veprimtarisë së këtyre organizatave në pikëpamje të zbatimit të dispozitave të ligjit me të cilat rregullohen çështjet e cedimit dhe të marrjes përsipër të punëve lidhur me ndërtimin e objekteve dhe rregullimin e marrëdhënieve reciproke; verifikimin e zbatimit të ligjit dhe të dispozitave të tjera, të standardeve, të masave teknike dhe të normave të cilësisë me rasin e projektimit dhe të ndërtimit të objektit; verifikimin e plotësisë të kushteve të përcaktuara për personat që kryejnë punët e projektimit, të kontrollit teknik, të udhëheqjes së ndërtimit dhe të mbikëqyrjes profesionale të ndërtimit të objektit;

kontrollin gjatë zhvillimit të punimeve me anë të të cilave verifikohet se a po ndërtohet objekti në bazë të lejes që është marrë më parë, përkatësisht sipas dokumentacionit teknik në bazë të të cilit është dhënë leja dhe verifikimin e kushteve të tjera të përcaktuara.

Neni 87

Organi i inspektimit kur vërteton se ndërtimi i objektit, përkatësisht zhvillimi i punimeve ka filluar pa lejen e organit kompetent, ka për detyrë që me aktvendim të urdhërojë menjëherë ndërprerjen e punimeve dhe me të njëjtin aktvendim të caktojë afatin brenda të cilit investuesi ka për detyrë të paraqesë prova se e ka marrë lejen për ndërtim, përkatësisht për zhvillimin e punimeve.

Kur organi i inspektimit konstaton se ndërtimi i objektit, përkatësisht zhvillimi i punimeve në objekt është kryer pa lejen e organit kompetent, ka për detyrë të marrë aktvendim për ndalimin e shfrytëzimit të objektit të këllillë dhe me të njëjtin aktvendim të caktojë afatin brenda të cilit investuesi ka për detyrë të paraqesë prova se e ka marrë lejen për ndërtim.

Afati nga paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë as më i gjatë se 90 ditë.

Përgjithësisht nga dispozitat e paragrafeve 1 e 2 të këtij neni, organi i inspektimit do të marrë aktvendimin për rrëzimin e objektit ose të një pjesë të tij pa urdhërin paraprak për ndërprerjen e punimeve, po qe se konstaton se objekti ndërtohet ose ndërtimi i objektit është bërë në tokën, e cila me planin urbanistik nuk është parashikuar për ndërtimin e këtij lloji të objektit apo në qoftë se objekti paraqet rrezik të drejtpërdrejtë nga zjarri, për sigurinë e komunikacionit dhe të objekteve fqinje.

Në rastin nga paragrafi 1 e 2 të këtij neni, investuesi nuk mund të vazhdojë ndërtimin e objektit, përkatësisht zhvillimin e punimeve para se të marrë lejen për ndërtim.

IX. DISPOZITAT NDESHKIMORE

Neni 88

Me gjobë prej 500.000 deri në 1.000.000 dinarë do të dënohet për delikt ekonomik organizata e punës së bashkuar dhe organizata ose bashkësia tjetër vetëqeverisëse që është investuese, po qe se:

1. fillon ndërtimin e objektit pa vendimin mbi ndërtimin e objektit (neni 14 paragrafi 1);
2. vendimin mbi ndërtimin e objektit e merr në kundërshtim me dispozitën e nenit 11;
3. vendimin mbi ndërtimin e objektit e merr në kundërshtim me dispozitën e nenit 16;
4. ndërtimin e objektit dhe zhvillimin e punimeve ia beson organizatës së punës së bashkuar në kundërshtim me dispozitën e nenit 53 paragrafi 3 të këtij ligji.

Për delikt ekonomik nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar, përkatësisht në organizatën ose bashkësinë tjetër vetëqeverisëse që është investuese me gjobë prej 20.000 deri në 50.000 dinarë.

Neni 89

Me gjobë prej 200.000 deri në 700.000 dinarë do të dënohet për delikt ekonomik organizata e punës së bashkuar dhe organizata ose bashkësia tjetër vetëqeverisëse që është investuese, po qe se:

1. nuk siguron zhvillimin profesional të të gjitha punëve investive (neni 25);
2. hartimin e dokumentacionit teknik ia beson organizatës së punës së bashkuar në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafet 1 dhe 2 të këtij ligji;

3. ndërtimin e objektit ia beson organizatës së punës së bashkuar, e cila nuk i plotëson kushtet nga neni 50 i këtij ligji;

4. ndërtton objektin për nevojat e veta, vlera paralogaritare e të cilit kalon shumën e përcaktuar në neni 51 të këtij ligji;

5. me marrëveshje të drejtpërdrejtë cedon ndërtimin e objektit ose hartimin e dokumentacionit teknik në kundërshtim me kushtet nga neni 60 dhe neni 61 paragrafi 1 e 2 të këtij ligji;

6. kryerjen e punëve të caktuara ose të të gjitha punëve lidhur me ndërtimin e objektit ia beson organizatës së punës së bashkuar, organizatës me kontratë të punës së bashkuar, kooperativës zejtare ose personit që ushtron veprimtarinë e pavarur zejtare e që nuk ka leje për kryerjen e punëve në të cilat bëjnë pjesë punimet që i janë besuar (neni 62 paragrafi 1).

7. pa ankand publik ia beson zhvillimin e punimeve organizatës me kontratë të punës së bashkuar, kooperativës zejtare ose personit që ushtron veprimtarinë e pavarur (neni 62 paragrafi 2).

Për delikt ekonomik nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar, përkatësisht në organizatën ose bashkësinë tjetër vetëqeverisëse që është investuese me gjobë prej 10.000 deri në 30.000 dinarë.

Neni 90

Me gjobë prej 300.000 deri në 700.000 dinarë do të dënohet për delikt ekonomik organizata e punës së bashkuar, e cila harton programin e investimit e nuk i plotëson kushtet e caktuara (neni 22 paragrafi 3).

Për delikt ekonomik nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar me gjobë prej 20.000 deri në 50.000 dinarë.

Neni 91

Me gjobë prej 200.000 deri në 700.000 dinarë do të dënohet për delikt ekonomik organizata e punës së bashkuar dhe organizata ose bashkësia tjetër vetëqeverisëse që e harton dokumentacionin teknik, po qe se:

1. hartimin e disa pjesëve të programit të investimit, që i është besuar, ia cedon organizatës tjetër të punës së bashkuar në kundërshtim me dispozitën e nenit 22 paragrafi 4 të këtij ligji;

2. harton dokumentacionin teknik e nuk u përmbahet kushteve nga neni 31 i këtij ligji;

3. nuk bën kontrollin e brendshëm të dokumentacionit të hartuar teknik (neni 33 paragrafi 1);

4. me rastin e hartimit të dokumentacionit teknik nuk i përmbahet programit të investimit dhe detyrës së projektit (neni 32 paragrafi 1);

5. bën kontrollin teknik të dokumentacionit teknik e nuk i plotëson kushtet për kryerjen e këtyre punëve ose bën kontrollin teknik të dokumentacionit teknik që nuk mund ta bëjë (neni 39 paragrafet 2 e 4);

6. me rastin e hartimit të dokumentacionit teknik nuk u përmbahet kushteve nga neni 74 paragrafi 1 i këtij ligji.

Për delikt ekonomik nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar, përkatësisht në organizatën ose bashkësinë tjetër vetëqeverisëse që e harton dokumentacionin teknik me gjobë prej 10.000 deri në 30.000 dinarë.

Neni 92

Me gjobë prej 10.000 deri në 600.000 dinarë do të dënohet për delikt ekonomik organizata e punës së bashkuar dhe organizata ose bashkësia tjetër vetëqeverisëse që është investuese, po qe se:

1. vendimin për ndërtimin e objektit e merr në bazë të programit, investiv që nuk i përmban të gjitha të dhënat e përcaktuara me këtë ligj (neni 18);

2. ia beson hartimin e programit të investimit organizatës së punës së bashkuar, e cila nuk është e regjistruar në regjistrin gjyqësor për kryerjen e këtyre punëve (neni 22 paragrafi 1);

3. harton programin e investimit e nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ose ia beson hartimin e programit të investimit bashkësisë punuese të organizatës punuese, përkatësisht të organizatës së përbërë, e cila nuk i plotëson kushtet e përcaktuara (neni 22 paragrafi 1);

4. hartimin e dokumentacionit teknik ia beson bashkësisë punuese të organizatës punuese, përkatësisht të organizatës së përbërë të punës së bashkuar në kundërshtim me kushtet nga neni 29 i këtij ligji;

5. hartimin e dokumentacionit teknik ia beson organizatës së punës së bashkuar, e cila e ka caktuar ndonjërin nga kushtet e ndërtimit (neni 30 paragrafi 5);

6. kontrollin teknik të dokumentacionit teknik ia beson organizatës së punës së bashkuar, e cila nuk është e regjistruar në regjistrin gjyqësor për hartimin e këtij lloji të dokumentacionit (neni 39 paragrafi 2);

7. i hyn ndërtimit të objektit pa lejen për ndërtim (neni 41 paragrafi 1);

8. nuk siguron mbikëqyrjen profesionale të ndërtimit të objektit, përkatësisht të zhvillimit të punimeve (neni 71 paragrafi 1).

Për delikt ekonomik nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar, përkatësisht në organizatën ose bashkësinë tjetër vetëqeverisëse që është investuese me gjobë prej 5.000 deri në 30.000 dinarë.

Neni 93

Me gjobë prej 100.000 deri në 600.000 dinarë do të dënohet për delikt ekonomik organizata e punës së bashkuar që ndërtton objektin, përkatësisht që i zhvillon punimet e tjera, po qe se:

1. ndërtton objektin ose i zhvillon punimet, kurse për kryerjen e këtyre punëve nuk i plotëson kushtet e përcaktuara (neni 50 paragrafi 2);

2. ndërtimin e objektit, përkatësisht zhvillimin e punimeve, që i janë besuar, ia cedon organizatës tjetër të punës së bashkuar në kundërshtim me kushtet e përcaktuara (neni 64 paragrafet 1 e 2);

3. me rastin e ndërtimit të objektit nuk u përmbahet kushteve nga neni 69 paragrafi 1 i këtij ligji.

Për delikt ekonomik nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar, e cila e ndërtton objektin përkatësisht i zhvillon punimet me gjobë prej 20.000 deri në 50.000 dinarë.

Neni 94

Me gjobë prej 100.000 deri në 500.000 dinarë do të dënohet për delikt ekonomik organizata e punës së bashkuar dhe organizata ose bashkësia tjetër vetëqeverisëse që e harton dokumentacionin teknik, po qe se:

1. hartimin e dokumentacionit teknik ia beson personit, i cili është në marrëdhënie pune në organizatën e punës së bashkuar, përkatësisht në organizatën ose bashkësinë tjetër vetëqeverisëse që është investuese ose organizatës që e ka dhënë ndonjërin nga kushtet për ndërtimin e objektit ose personit, i cili bën mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji (neni 30 paragrafi 6);

2. nuk e njofton investuesin se zgjidhjet tekniko-teknologjike të parashikuara me programin e investimit nuk u përgjigjen të arriturave shkencore dhe teknike bashkëkohore (neni 32 paragrafi 2);

3. punët e projektuesit përgjegjës i kryen personi që nuk i plotëson kushtet nga neni 35 paragrafi 2 i këtij ligji;

4. hartimin e dokumentacionit teknik e bën personi që nuk i plotëson kushtet e përcaktuara (neni 37);

5. nuk ia tërheq vërejtjen investuesit për parregullsitë që i konstaton gjatë procedurës së kontrollit teknik të dokumentacionit teknik (neni 40 paragrafi 4).

Për delikt ekonomik nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar, përkatësisht në organizatën ose bashkësinë tjetër vetëqeverisëse që e harton dokumentacionin teknik me gjobë prej 5.000 deri në 20.000 dinarë.

Neni 95

Me gjobë prej 50.000 deri në 300.000 dinarë do të dënohet për delikt ekonomik organizata e punës së bashkuar dhe organizata ose bashkësia tjetër vetëqeverisëse që është investuese, po qe se:

1. cedon ndërtimin e objektit, përkatësisht zhvillimin e punimeve ose hartimin e dokumentacionit teknik në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës (neni 53 paragrafi 2);

2. në procedurën e ankandit publik nuk siguron pjesëmarrjen e barabartë të të gjithë pjesëmarrësve të interesuar (neni 55 paragrafi 2);

3. mbikëqyrjen profesionale ia beson organizatës së punës së bashkuar, e cila nuk është e regjistruar në regjistrin gjyqësor për kryerjen e punëve të hartimit të dokumentacionit teknik ose organizatës që bën shërbime tekniko-ekonomike (neni 72, paragrafi 1).

Për delikt ekonomik nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar, përkatësisht në organizatën ose bashkësinë tjetër vetëqeverisëse që është investuese prej 10.000 deri në 30.000 dinarë.

Neni 96

Me gjobë prej 50.000 deri në 100.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje organizata e punës së bashkuar dhe organizata ose bashkësia tjetër vetëqeverisëse që është investuese, po qe se:

1. kryen punët nga neni 25 paragrafi 1 i këtij ligji e nuk i plotëson kushtet e përcaktuara (neni 25 paragrafi 2);

2. investuesi brenda afatit të caktuar nuk siguron lejen për ndërtimin e objektit (neni 43 paragrafi 3);

3. nuk e njofton organin kompetent për fillimin e zhvillimit të punimeve ose nuk i paraqet ato brenda afatit të përcaktuar (neni 47 paragrafi 1);

4. ndërton objektin nga neni 60 i këtij ligji, kurse ndërtimin e udhëheq personi që nuk i plotëson kushtet nga neni 51 i këtij ligji;

5. shpalljen për ankandin publik nuk e publikon në mënyrën e përcaktuar me nenin 56 paragrafi 1 të këtij ligji;

6. në aktin mbi pranimin e ofertës nuk i përmend arsyet për të cilat ofertën e ka vlerësuar si më të volitshme apo në ofertë se nuk i njofton pjesëmarrësit në ankandin publik se ankandi nuk ka pasur sukses (neni 58 paragrafi 5);

7. nuk lidh kontratë me shkrim për ushtrimin e mbikëqyrjes profesionale (neni 72 paragrafi 2);

8. mbikëqyrjen profesionale të ndërtimit të objektit e bën personi që nuk është në marrëdhënie pune në këtë organizatë ose personi që nuk i plotëson kushtet e përcaktuara.

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar, përkatësisht në organizatën ose bashkësinë tjetër vetëqeverisëse që është investuese me gjobë prej 2.000 deri në 20.000 dinarë.

Neni 97

Me gjobë prej 50.000 deri në 100.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje organizata e punës së bashkuar që e harton dokumentacionin teknik, po qe se:

1. kontrollin e brendshëm e bën personi që nuk është në marrëdhënie pune në këtë organizatë ose personi që nuk i plotëson kushtet e përcaktuara, ose personi që ka marrë pjesë në hartimin e dokumentacionit (neni 33 paragrafet 4 e 5);

2. nuk mban evidencën e dokumentacionit të hartuar teknik dhe të dokumentacionit që është në hartim e sipër (neni 34 paragrafi 2).

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar që e ka hartuar dokumentacionin teknik me gjobë prej 2.000 deri në 20.000 dinarë.

Neni 98

Me gjobë prej 50.000 deri në 100.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje organizata e punës së bashkuar që e ndërton objektin ose zhvillon punimet e tjera, po qe se:

1. nuk paraqet ditën e fillimit të ndërtimit, përkatësisht të zhvillimit të punimeve (neni 67);

2. nuk cakton periodën që udhëheq ndërtimin e objektit, përkatësisht zhvillimin e punimeve ose cakton personin që nuk i plotëson kushtet e përcaktuara (neni 68);

3. nuk mban ditarin e ndërtimit dhe librin e inspektimit (neni 70 paragrafi 1).

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar që e ndërton objektin me gjobë prej 2.000 deri në 20.000 dinarë.

Neni 99

Me gjobë prej 5.000 deri në 20.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës në organin e administratës, po qe se:

1. brenda afatit të përcaktuar nuk e jep lejen për ndërtim (neni 42 paragrafi 1);

2. brenda afatit të përcaktuar nuk e jep lejen për përdorimin e objektit (neni 83 paragrafi 1);

3. nuk e urdhëron investuesin që të marrë lejen për ndërtim sipas dokumentacionit të ndryshuar teknik ose nuk urdhëron zgjidhjen për atë pjesë të objektit, përkatësisht nuk urdhëron mënjanimin e parregullsive në ndërtim, harmonizimi i të cilave nuk është bërë ose nuk është i mundshëm (neni 87 paragrafi 4).

X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 100

Organizatave të punës së bashkuar që kryejnë punët e hartimit të dokumentacionit teknik dhe të programit të investimit, organizatat që bëjnë shërbimet konsalting dhe që i ndërtojnë objektet, si dhe që bëjnë mbikëqyrjen profesionale të ndërtimit të objekteve, e kanë për detyrë që veprimtarinë e vet ta harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji brenda afatit prej një viti, nga dita e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 101

Dispozitat që janë nxjerrë në bazë të Ligjit mbi ndërtimin investiv („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 39/72 dhe 26/73), do të aplikohen deri në nxjerrjen e dispozitave të parashikuara me këtë ligj, po qe se nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Dispozitat e parashikuara me këtë ligj, do të nxirren brenda afatit prej një viti, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 102

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji mbi ndërtimin e objekteve investive („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 39/72 dhe 26/73).

Neni 103

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë, pas shpalljes në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.